

BIBLIOTEKA

814-1

PL4

GJIROKASTER

SHLHHS  
LIBRARY

NDOC  
PAPLEKA



POEZI

884-1 1986  
P24.

NDOC  
PAPLEKA



48748

Rrathët  
e lisit

\* POEZI

SHTËPIA BOTUESE  
«NAIM FRASHERI»

## *Rrathët e lisit*

'Thith nëpër stinë shi e diell,  
thith gjirin e fortë të tokës.

Erërat që përplasen mbi të  
e bëjnë t'i shtrijë rrënjet më thellë,  
ia kalitin qëndresën.

Nuk dehet nga ylberët,  
nga vallet e kristalta të borës  
as me dritë hëne.

I heshtur dhe i blertë,  
drithërohet vetëm nga zogjtë  
që pushojnë mbi të,  
ose bëjnë çerdhen në degët e tij.

Nuk e pikëllojnë gjethet e verdha  
që rrëzohen çdo vjeshtë,  
sepse çdo vjeshtë shkunden

edhe lëndet  
me të cilat shumëfishon vetveten.

Nuk ka frikë nga qiejt,  
nga rrebeshet dhe rrufetë e zjarcta,  
që një ditë mund të bien mbi të.

Thith nëpër stinë shi e diell,  
thith gjirin e fortë të tokës  
dhe rrënjet e tij kapen fort pas saj  
si dora e një fëmije që e ka marrë uria  
pas gjirit të nënës.

Ai e di se lartësia e tij  
varet nga thellësia e rrënjeve.

I heshtur dhe i blertë,  
rrit rrathët e tij.

Thadron në ata rrathë  
imazhin e rrumbullakët të diellit,  
jetën dhe moshën e vet.

*Me ty ngjitemi, Parti*

Na mungonin edhe buka, edhe èndrra  
dhe ne ishim tè uritur pér tè dyja,  
por ti asnijéherë s'na fole pér parajsën:  
na the se jeta do tè bëhej më e mirë  
nga pëllëmbët tonë tè vëllazëruara,  
nga djersa dhe shqetësimi i përditshëm.

Na nxite tè èndërtrojmë tè pamundurën  
dhe tè pamundurën ta bëjmë reale,  
por ti asnijéherë s'na fole pér parajsën;  
kur buka u shtua nëpér sofrat tonë  
dhe drita tek ne u bë më e madhe.  
Ti na the se ky ishte vetëm fillimi.

Na tregove te fjala jote prej dielli  
fytyrën e qartë tè ditëve tè nesërme,  
por ti asnijéherë s'na fole pér parajsën;

kur u nisëm, e dije ku do të arrnim  
dhe kur arritëm, na the të niseshim prapë —  
të jetosh vërtet do të thotë të ngjitesh...

Me ty ngjitemi sì pema që rritet, Parti.

*Një epitaf për Besnikun*

...U nda prej nesh Besniku  
si një diell vere që perëndon mbi det  
pasi i ka dhënë ditës tërë rrrezet e tij.

Në fytyrat tona ra muzgu i pikëllimit  
dhe sytë tanë morën një ngjyrë çeliku  
si deti pas perëndimit të diellit,  
sepse na deshi  
dhe e deshëm...

U nda prej nesh Besniku,  
por në lulet e kuqe, të mbira përballë detit,  
mbetën pikat e gjakut të tij  
që lulëzojnë çdo verë.

Në gurthemele uzinash, ndërtesash,  
që ruajnë prekjen e gishtave të tij,  
në pëllëmbët e qindra njerëzve  
mbeti ngrohtësia e duarve të Besnikut.

Në ison labe që ngrihet majë maleve,  
në zërin e popullit të tij që jehon në planét,  
në thirrjen ngadhënje të komunistëve  
zëri i Besnikut mbeti.

...U nda prej nesh Besniku  
dhe la si statujë në mes të zemrës sonë  
amanetin e tij.

**Shtator 1979**

## *Shkrirësi dhe zogu*

Në dritaren e hapur të uzinës  
ndalet e cicëron një zog i larmë  
me një fije bari në sqep  
e me kaltërinë e prillit në zë.

Shkrirësi e shikon dhe buzëqesh  
me pranverën që solli zogun në dritare,  
me fijen e barit në sqep të tij  
dhe me atë cërr-cërr të hareshëm.  
I kujtohet zogu që cicëroi mbrëmë  
në degën e gjethuar të plepit,  
kur një vajzë si fije bari  
i dha të puthurën e parë.

Zogu cicëron e fluturon tutje  
me fijen e barit në sqep  
e me kaltërinë e prillit në zë.

Shkrirësi përkulet mbi metalin e zjarrtë,  
që lëshon luzma xixëllonjash  
dhe në zemër i cicëron pareshtur  
zogu me fijen e barit në sqep.

## Korrík

E paanë, e paanë  
fusha e artë!

Erashka vigane e grunjérave  
nëpër muzg luhatet.

E paanë, e paanë  
fusha e artë!

Zogjtë e përgjumur të duajve  
nëpër fushë janë shpérndarë.

E paanë, e paanë  
fusha e artë!

Sonte Kashta e Kumtrit  
rrjedh nga shkarkuesi i kombajnës.

E paanë, e paanë  
fusha e artë!

## *Dashuria e nënës*

U njoha me të në Fierzë.  
Megjithëse nuk e pinte duhanin,  
më tha se mbante në xhep gjithmonë  
një kuti shkrepëseje.  
Atë shkrepëse ia kishte dhënë e ëma  
që t'i ndodhej me vete për çdo rast.  
Më tha se një natë në tunel  
nga një shembje ishin fikur dritat papritmas  
dhe ai kishte shpëtuar pa u rrëzuar  
bashkë me disa shokë të tjera  
nga shkrepësja që i kishte dhënë e ëma.  
Më tha se kur shkonte në shtëpi,  
çdo herë nëna i shihte xhaketën:  
po të ishte mbaruar shkrepësja,  
blinte një tjetër dhe e vinte aty.  
E mora në dorë atë shkrepëse të thjeshtë  
dhe mendova se dashuria e nënës  
edhe me disa fije druri bën një diell  
dhe drita e saj është e domosdoshme

si te kthina e fshatit që bie erë ftua  
edhe te ky hidrocentral vigan —  
ajo është në zanafillë të çdo drite.

### *Trashëgimi i gjyshes*

S'është më gjyshja ime  
si një hartë mitike e prejardhjes.

Më kujtohen flockët e saj të kuqërremtë,  
— edhe në pleqëri —  
si retë që i ndez dielli në mbrëmje  
dhë fytyra e saj si lëvore e bronztë pishe,  
e rrudhosur nga dhimbjet.

Më kujtohet xhubleta e saj  
— kambanë që lëshonte vezullime —  
që e veshi vetëm në nusëri dhe ditën e vdekjes  
bashkë me brezin e lashtë prej argjendi.

Dhe më vijnë nga fëmijëria  
— si nga një grykë e thellë —

rrëfenjat dhe këngët e saj  
me emra lumenjsh dhe fushash të panjohura,  
më e bukura antologji e botës.

Një gjeografi e dhimbshme e mallit,  
fusha dhe lumenj të mbartur në kujtesë,  
të shndërruar në mish legjendash  
bashkë me pikëllimin dhe lotët e ikjes...

Më vonë i njoha në libra  
ato fusha dhe lumenj të panjohur,  
që më tingëllonin për çudi të afërm  
me zërin e gjyshes brenda rrrokjeve të tyre.

S'është më gjyshja ime  
si një hartë mitike e prejardhjes,  
por fushat dhe lumenjtë që mbarti në kujtesë  
shtrihen në hapësirat e vetëdijes sime  
të zhveshur nga lëvozhga e mitit...

## *Në shkollën e mbrëmjes*

I vagëllohen sytë  
nga gjumi, nga lodhja.  
Në brinjë e godet fëmija  
që ende s'ka ardhur në jetë.  
Sytë e saj bëhen ëndërrimtarë  
si qelli mbi një luginë  
plot re të bardha —  
premtive shirash, të korrash  
dhe frutash të pjekur.  
Ajo ëndërron për fëmijën  
që në brinjë e godet.  
Orët e mësimit janë të gjata  
dhe qepallat i rëndohen  
por ajo e di se mëson  
edhe për atë që do të vijë në jetë.  
Jashtë yjet farfurijnë mbi borë.  
Sytë e saj ëndërrimtarë  
mbushen me dritë hënore  
si kjo mbrëmje janari.

## *Një poeti të ri*

Ti vjen në pallatin tim dhe më sjell vargjet e tua  
që énde mbajnë afshin e të krijuarit, si bulkë e  
ngrohtë.

Unë vij në shtëpinë tënde të gurtë, të sjell vargjet  
e mia  
dhe ti i mban fletët me butësi në duar  
sic mbaje pëllumbat e vegjël kur ishe fëmijë.

Ti i lexon vargjet e mia dhe të ndritin sytë.  
Unë lexoj vargjet e tua dhe atë çast e ndiej veten  
si ai që ngrihet herët dhe sheh rrrezet e para,  
më vonë rrrezet e diellit do t'i ngrohin të gjithë...

Ecim së bashku duke biseduar nëpër rrugë  
për kohën tonë, pér botën, pér librat e poetët...  
Gëzohemi kur flasim pér krijimet tona të sapofilluara,  
gëzohemi kur i japim mendime njëri-tjetrit.  
Duke qenë bashkë jemi më të mençur.

Zogjtë nëpër pemë nuک këndoijnë të vetmuar.  
Ne jemi si zogjtë që rrinë në degë pranë njëri-tjetrit  
dhe me këngët e tyre së bashku ndjellin verën.

Vetëm qyqja këndon e vetmuar, vetëm qyqja...  
dhe qyqja di vetëm një këngë: ku-ku-ku!  
mjerë poeti-qyqe, mjerë poeti i vetmuar.

Ne jemi si zogjtë që këndoijnë së bashku në një  
pemë:  
secili ka pendët e tij, ka cicërimat e tij  
dhe asnjeri prej tyre s'i ka smirë të tjerët.

Mjerë poeti-qyqe, mjerë poeti i vetmuar!

48148

## *Në rru gë*

Agimi prej bore dhe drite  
sikur del nga toka.

Nëpër rrugën malore zbrësin  
makinat me trupa të rëndë.

Mbi to shtrohet bora e re  
si qilim i madh dasme.

Përmes xhamave të fshirë  
shoferi sheh flokët e borës.

Në këtë nusërim të plotë  
i bie në mend e fejuara.

Tytyja gazmore e borisë  
midis maleve shtegton tutje.

Makinat rrëshqasin mbi borë  
si në një peizazhë e ndrre.

Njeriu ndien brenda vetes  
pafundësinë e hapësirës së bardhë.

## *Murana e fundit e gjakmarrjes*

Në fshatin tim është një kullë e rrënuar  
pa dritare, pa dyer,  
pa rrugë që të çon te pragu i saj.

Kështu e mbaj mend që nga fëmijëria —  
kur kaloja pranë saj hardhucat zbrisnin nga muret,  
gjarpérinjtë fishkëllinin e rrëshqisnin midis hithrave.

E gjyshja më fliste për gjaqe të vjetra,  
për burra të vrarë, të shtrirë në vigje,  
për kukatjet e nënave e të nuseve.

Natën dëgjoja ulëriimat e kuçuvajkës  
dhe mua më dukej sikur ulërinte në errësirë  
kulla e shkretë midis barit...

Në fshatin tim është një kullë ngujimi  
pa dritare, pa dyer,  
pa rrugë që të çon te pragu i saj —

Murana e fundit e gjakmarrjes.

## *Fëmija me balonë*

Pulëbardhë pa sy dhe memece  
balona sillej mbi mollët e lulëzuara,  
ndërsa fëmija queshte te dritarja  
duke i falur sytë dhe zërin e vet.  
Befas muret e shtëpisë u drodhën,  
çatia lëshoi një krra-krra të frikshme  
si një korb që fluturon në muzg.  
Fëmija u fundos në mjegullirë  
dhe balona humbi në qiellin e paanë,  
duke kërkuar më kot duart e fëmijës.  
Kur erdhi në vete disa orë më vonë,  
fëmija pa rrëth tij njerëz me të bardha  
dhe u kërkoi balonën e humbur.  
Mjekëve të shqetësuar u qeshi fytyra,  
sytë e tyre u mbushën bardhësi  
si me një grumbull balonash.  
Njëri i solli një balonë të madhe  
dhe i tha se e gjeti duke pritur te dera.

Fëmija u kthye në fshatin e tij,  
ku disa njerëz të panjohur nga jugu  
po hapnin themellet e shtëpive të reja.  
Ai e lidhte balonën në degën e një molle  
dhe u çonte vullnetarëve nga një tullë.  
Në vjeshtë bashkë me kuqjen e mollëve  
u ngritën shtëpitë e shembura nga tërmeti,  
me mure të bardha e me çati të kuqe.  
Fëmija sillej nëpër shtëpinë e tij të re  
dhe e ndiente veten të sigurt në të  
si farat brenda kokrrës së mollës.  
Kur vullnetarët nga jugu u larguan,  
fëmija i fali një muratori balonën  
që t'ia çonte vogëlushit të tij.

### *Vlorës*

Gjithnjë më ke pritur  
dulke tundur në erë  
duart e palmave të tua.

Mirë se vjen, o bir,  
Mirë se vjen!...  
Më ka thënë edhe deti.

Gjithnjë e kam diitur  
se të përkas edhe ty  
po aq sa dhe bjeshkëve.

E ti më ke përshëndetur  
me duart e palmave,  
me të qeshurat e shkumës.

Dhe atë ditë e sot  
i dashuruar kam mbetur me ty,  
sirenë toke dhe uji.

## *Kur i buzëqeshnim njëri-tjetrit*

Vite më parë, në breg të Vlorës mblodha me ty  
iriqë deti...

Hapnim brezare, shkulnim rrënëjë e dignjim prralle.  
Thithnim me erën e rrënëjëve të djegura erë lulesh  
dhe erë dafine si frysëmarrje përjetësie.

Hapnim brezare, mbillnim ullinj në shpate kodrash,  
mbillnim limonë e portokaj përballë detit.

I buzëqeshnim njëri-tjetrit siç qeshite deti  
i lashtë me brigjet...

Me duart tonë thekur nga dielli të ashpëruara,  
i përkëdhelnim ato stërkala prej shkuime e kripe.  
Ndiqnim me sy ato pulëbardha që përmbi det

rrinin si èndrrat mbi moshën tonë  
e na magjepste ai fluturim mbi kaltërsinë e

pambaruar.

Midis guaskash e leshterikësh mblidhni së bashku  
iriqë deti —

ata lëshonin një lëng të purpurt si qumësht shege,  
një kundërmim të fortë, të ëndshëm.  
Dhe qelli i jugut varej mbi ne, frut i madh blu,  
dhe i buzëqeshnim njëri-tjetrit siç qeshte deti  
i lashtë me brigjet...

Kanë çelur lule ato mënjolla që mbollëm ne,  
kanë lidhur kokrra  
dhe kundërmon atje dafina si frymëmarrje përjetësie,  
dhe më sjell juga erë limonësh e portokajsh,  
klithma pulëbardhë dhe kundërmim iriqësh deti,  
dhe kam në sy atë quell vere, frut i madh blu,  
dhe ato çaste kur i buzëqeshnim njëri-tjetrit  
siç qeshte deti i lashtë me brigjet...

Iriqë deti, iriqë deti që s'jemi më,  
lëngun e purpurt dhe erën tuaj s'e kam harruar  
dhe s'do të mundem t'i harroj kurrë as ato brigje,  
as atë verë!

## *Mullarët e vjeshtës*

Ikën të korrat,  
ikën ditët me diell  
dhe kurrilat e fundmë...

Vetëm ju keni mbetur  
midis fushës së zbrazët  
për të na kujtuar verën.

Mullarë të praruar —  
një tufë me lirika.  
në hirnosjen dhe heshtjen e fushës.

## *Trëndafili që më solle në spital*

Trëndafili që më solle në spital  
kundërmon te kryet e shtratit tim  
dhe më flet për tokën, për diellin.  
Trëndafili që më solle në spital  
më flet për stinë e kopshte të largëta  
ku i kam takuar trëndafilat dikur.  
Trëndafili që më solle në spital  
më flet për mbrëmjet e dashurisë sonë,  
për puthjen e parë pas një trëndafili.  
Trëndafili që më solle në spital  
më kujton aromën e flokëve të tu  
të lidhur me një fjongo të kaltër.  
Trëndafili që më solle në spital  
edhe në heshtje, në mugëtirën e natës,  
më flet për hapësirat për zogjtë  
dhe për agullimin e purpurt...  
Trëndafili që më solle në spital  
kundërmon te kryet e shtratit tim.

## *Fyelli i Panit*

«Ka vdekur Pani!... Ka vdekur Pani!...»  
Sokëlliten detarët mbi një anije  
muzgu u përgjak prapa malit  
si një fytyrë e gërvishjtur.

U thërrmuau mbi shkëmbinjtë e kërleshur  
mijëra stërkala të bardha Joni...  
Por detarët që sokëlliten buzë detit  
ishin të paguar nga Roma.

Udhëtuan ata në brigjet e Mesdheut,  
lajmin e rremë ngado e shpërndanë.  
Pani midis tufës, lart në bjeshkë  
i binte fyellit ilirian.

U rropos Roma perandorake,  
bronzi i borive tē saj u ngjirr:  
nuk heshti kurrē fyelli i Panit,  
kulloit mjaltē e qumësht hëna prej tij.

## *H i j e t*

Në një tavan të errët kulle  
me tratë të nxirë, të brejtur nga krimbi,  
me cerga merimangash në dërrasat e murrme,  
ku ruheshin njollat e gjakut të një banditi,  
ishin sjellë fshehurazi nga kisha e fshatit  
(që u bë vatër kulture dhjetë vjet më parë)  
veladoni i zi i fratit,  
ikona, shenjtorë gipsi, ungjij me kapakë të artë.  
Rrinin shenjtorët në mugëtirën e kullës  
aty ku strukeshin dikur diversantët.  
Shënkollit i varej koka në tel të armaturës,  
Krishtit të kryqëzuar iu kishin thyer krahët.  
Ato hije që u kishin sjellë bukë kur binte nata  
diversantëve të fshehur në tavan  
tashti sillnin tinëzisht parà e dhurata  
në kishën ilegale, për zotin ilegal...  
Por ata që kishin zbuluar banditët  
dhe i kishin shfarosur me krisma pushkësh  
zbuluan shenjtorët ilegalë, ikonat, ungjijtë,  
e zhdukën hibridin përbindësh të kishë-kullës.

Dhe u bë një gjyq i hapur në fshat  
për hijet e zeza që vërtiteshin netve,  
kurse truporet, ikonat, ungjijtë

me një procesverbal  
iu dorëzuan përgjegjësit të muzëve.

Natyrisht

ringjallja e kësaj kishe në fund të viteve '70  
është një gjë absurdë dhe e rrallë,  
është thjesht si rritja e thonjve tek të vdekurit,  
por ajo mund të shndërrohej në vampirin e  
përrallës!

1978

## *N d j e s i*

Së largu dëgjoj  
një të qarë fëmije,  
njëqind veshë hapen  
nëpër qenien time.

Hapen drithërima  
brenda në trup  
si rrathë të panumërt  
kur guri bie në ujë...

Së largu dëgjoj  
një të qarë fëmije,  
gjithnjë më duket  
sikur qan im bir.

E di, kështu ngjet  
me prindër të tjerë:  
kur një dru shushurin,  
e imiton pylli i tërë.

## *V e n d l i n d j a*

Shtëpi të gurta që varen në shkëmbinj  
si hoje bletësh të egra.

Në rrugët e tua mësova të eci,  
në lëndinat e tua mblodha lule,  
nga drurët dhe gjethet e tua  
nxora tinguj e këngë.

Nga njerëzit e tu  
mësova si kthehet guri në bukë,  
hapësira e livadheve në blegërimë qengji  
e në curril qumështi.

Nga burrat dhe gratë e tua  
mësova si kthehet njeriu në gur  
përpara dhimbjes.

Nga njerëzit e tu të urtë e të çiltër  
mësova si lind dielli nga fjala  
dhe nga zemra e bardhë.

S'të kam harruar kurrë,  
mësa mund të harroj burimin  
e të shkëputet prej tij  
lumi  
sado larg që të shkojë.

*I kuq është dielli që perëndon këtë mbrëmje*

I kuq është dielli që perëndon këtë mbrëmje  
si trëndafili i kuq që mban ndër dhëmbë një  
marangoz,  
duke mbërthyer në oborr një valixhe të drunjjtë.

Troket çekani mbi dru si qukapikët në pyll —  
gjithmonë ka ardhur një qukapik nga pylli i largët  
për të trokitur e klithur në mendimet e  
marangozit.

Gjithmonë pylli i largët ka lëshuar një oh,  
pas çdo të rëne të sëpatës mbi lis,  
pas çdo goditjeje të çekaniit mbi dru...

Marangozi i moshuar, i përkulur si lisat pleq,  
që ka më duar dhe gishta mbresa plagësh,  
ka mbërthyer në jetë djepe, shtretër, dritare.

Asnjëherë qukapiku i pyllit të largët  
nuk ka trokitur kështu në kraharorin e tij  
dhe s'ka klithur kaq hareshëm sa sot.

Me këtë valixhe që do ta lyejë më bojë të gjelbër  
do ta nisë të birin më shkollën e pyjeve,  
ku do të mësojë të arritë e të mbrojë drurët.

## *Të pish në burim*

Të ulesh me gjunjë mbi rrasa,  
të mbështetësh pëllëmbët mbi myshk,  
të prekësh me buzë cipëzën e ujit,  
të drithërohesh nga kjo prekje e freskët,  
të pish duke ndier vetëm kundërmimin e tokës,  
të pish e të të duket sikur po pi jo vetëm ujë  
por edhe një degë lajthie që të varet mbi krye,  
edhe një re të vogël që nxiton në qiell,  
edhe një krah të larmë zogu që klith mbi ty,  
edhe një rreze dielli që bie përmes gjetheve,  
edhe ngjyrën e gjelbër të barit rrëth burimit,  
madje edhe fytyrën tënde të pasqyruar në ujë,  
fytyrën tënde të dikurshme prej fëmije...  
**Të pish te burimi i jetës, i fjalës**  
si të pish në burim ujë burimi.

## *Antiburokratike*

E gjeta në rrugë me sy të përlotur  
nxënësin tim të urtë, nxënësin tim të mirë,  
nxënësin tim që ishte i pjekur si një burrë  
dhe i drojtur si një zog.

Nxënësin tim që vinte nga kulla përtej lumi  
me vetullat tërë brymë nga mjegulla dimërore,  
që i çelte një luleborë e papritur te buza  
kur i via dorën në sup dhe flisja me të,  
kur e çoja të ngrohej pranë stufës...

E gjeta në rrugë me sy të përlotur  
nxënësin tim të urtë, nxënësin tim të mirë  
dhe në ato bulëza loti, ah, në ato bulëza loti  
për një çast m'u duk se humbi ajo ditë vere,  
rruga plot diell që kundërmonte lule bliri,  
e qeshura e fëmijëve që rrokulliseshin mbi bar.

**M'u duk sikur zgërdhihej burokrati i urryer**  
që e hoqi nga lista e të drejtave të studimit  
për të vënë emrin e djalit të një mik...

E mora për krahu nxënësin tim të burrëruar,

nxënësin tim të urtë, nxënësin tim të mirë,  
te shokët e Partisë ne shkuam së bashku.

Nga sytë e qiltër iu davaritën bulëzat e lotit  
dhe i çeli prapë lulebora te buza...

Pa Partinë,

të pikëlluar do të ishin sytë e mi, sytë e tu  
dhe mijëra sy fëmijësh do të ishin të përlotur,  
nxënësi im i urtë, nxënësi im i mirë!

## *G r e r ë z a t ...*

Mbi vilet e rrushit të pjekur  
Vërtiten grerëzat...

(Rreth vajzave tona të mira  
vijnë rrotull shkesët.)

Në lastarët e gjatë të hardhive  
Rëndoijnë bistakët e rrushit...  
(Duart e shpejta të vjelësve  
kundërmojnë nga mushti.)

Kokrrat e fryra, të arta  
pëlcasin mën diellin e verës...  
(Kumbojnë dollitë e dasmës  
në ëndrrat e vjelëseve.)

Grerézat e verdha värtiten  
rreth një veshuli të tharë...

(Kokulur rrinë shkesët  
pranë filxhanëve të zbrazët.)

## Në bregdet

Të hidhura qenë mendimet e të parëve të mi pér detin.

Ata kujtoheshin pér të në kohë thatësire kur nuk dukej asnje re në qiell, kur shtrenjtohej a mungonte kripa, ose kur shfaqej ndonjë pushtues i ri diku në brigjet e largëta.

Ata e duronin thatësirën si shkëmbinjtë e tyre të zhveshur — E duronin edhe mungesën e kripës dhe heshtnin me një shtangim statuje. Po kur i huaji dilte nga deti, me një rreng të lashtë e të rëndë, ata turreshin si përrrenj nga malet me sëpata e huta të moçme.

Në rërën e freskët mbeteshin pllanga gjaku dhe murana që kurorëzoheshin nga shkuma. Ata ktheheshin prapë në malet e tyre me plagë të reja në trup,

me guaska deti që ua çonin grave  
për t'ua varur fëmijëve te djepi...  
Eci nëpër rërën e nxeh të  
përmes prekjes së saj ndiej në trup  
praninë e maleve të grimcuara nga koha  
dhe të stërgjyshërvë të mi.  
Hija e tyre tragjike dhe krenare  
më ndjek prapa kudo në këto brigje  
si hija ime mbi rërë.

## Në 35-vjetorin e brigadës XXV S

Mbrëmë

në shtëpi në tonë do të vinte një ish-partizan nga  
Hasi.

Ne u bëmë gati për ta pritur atë  
siç mund të pritet një njeri shumë i dashur.  
Shikuam ta talkonim në vendin e rreshtimit,  
por një shok nga fshati i tij na tha  
se partizani që kërkonim kishte vdekur pardje...  
Të pikëlluar e të heshtur u kthyem në shtëpi.  
Mbrëmë shtëpia jonë na u duk çuditërisht e zbrazët,  
aty kishte diçka nga heshtja dhe mungesa e madhe  
e 28 mijë të rënëve  
që munguan atë natë kur erdhi liria.

Të pikëlluara ishin edhe mollët më tryezë,  
gotat me të cilat do të ngrinim shumë dolli  
me ish-partizanin nga Hasi që nuk erdhi.  
Vogëlushi im sillej mëpër shtëpi, kërkonte me ngulm:  
«Ku është partizani?... Dua të vijë partizani!...»

Ne i thamë se do të vinte më vonë dhe ai e priti  
derisa e mori gjumi.

Por partizani nuk erdhi  
siç nuk erdhën 28 mijë të rënë atë natë kur erdhi  
liria.

Ti do të rritesh, vogëlushi im, dhe do ta kuptosh  
se partizanët në jetën tonë janë përherë të pranishëm.  
Ata luftuan të mos mungojnë në shtëpitë tona  
buka, mollët, drita, dollitë...

Të rënët munguan të mos mungojë liria.

## *Matematika e trimërisë*

Shtrirë pranë e pranë sikur dje në luftë  
në një brinjë mali, në një pllajë me borë,  
flenë të rënët tanë nën pllaaka mermari...  
Kaloj përbri tyre dhe lexoj në heshtje  
emrat e skalitur në mermari të bardhë,  
zbres datën e lindjes nga data e vdekjes:  
Ahmet Zeneli — 1944 pa 1928 baras 16,  
Jahë Zenuni — 1944 pa 1926 baras 18;  
Jup Bajrami — 1945 pa 1925 baras 20...  
Matematikë e dhimbjes dhe e trimërisë  
qenkan këto shifra të ngulura në gur!  
Dhe mendoj me vete se duhet të mbledhësh  
vitet e gjithë brezave që do të vijnë këtu,  
për të gjetur kohën e pavdekësisë së tyre,  
moshën e lirisë që na sollën të rënët.

*Skicë për portretin e Ramë Sadrisë*

Ky mal në mes të bjeshkës  
me shtat të lartë prej guri,  
me yllin e mbrëmjes të ndezur në majë,  
me tëbana e qyteza gjeologësh përreth,  
që ngashërehet e jehon i gjithi  
nga këmborët dhe blegërimat e grigjave,  
nga fjalë dhe të qeshura punëtorësh  
dhe nga hapat e sigurt të kufitarëve,  
që përgjon pipëtimat e erës në gjethë,  
murmurimën e ujit nëpër bar  
dhe klithmat e zogjve të natës,  
pikat e vesës që bien mbi foletë e shqiponjave  
dhe mbi krahët e sokolave të përgjumur,  
ky mal në mes të bjeshkës  
me pika gjaku në rrënje të pishave  
a nuk është portreti i Ramë Sadrisë?

*Koha e kërkon njeriun me flatra*

**Azem Galicës**

Të jesh njeri si të gjithë njerëzit  
e të vësh flatra nën sqetull, si në mite,  
sepse koha e kërkon njeriun me flatra.

Të mos kesh zë të flasësh me kaun në arë  
e të kesh njëqind zëra për t'i thirrur dushmanit,  
sepse koha kërkon të sokëllish në njëqind prita.

T'i japësh krahët e tu shqiponjës dykrerëshe  
e flatrat e saj t'ua lësh fëmijëve,  
sepse koha e kërkon njeriun me flatra.

Të luftosh edhe me vdekjen tënde.

Të mbetesh fluturim midis jetës e vdekjes,  
si një shpend i madh që fluturon  
midis natës që ikën dhe lindjes së diellit...

Çdo kohë e kërkon njeriu me flatra.

## *Kulla e braktisur*

**motiv kosovar**

Kullë e braktisur... Një dry te dera  
si hënë e ndryshkur e natës sate  
pa yje dritash, sysh, të qeshurash,  
pa prush në vatër, fjalë njerëzore,  
pa thirrje nënash, kollitje pleqsh  
e pa të qara vogëlushësh...

Vetëm në heshtje, në mugëtirë  
hije stërgjyshërish lëvizin lehtas,  
futen në kthina, ulen te vatra  
ku ka thëngjij e hi të ftohtë  
e të kërrusur rreth saj dënesin  
siç qanë me gjëmë dikur të vdekurit.

Po qajnë të pikëlluar  
bijtë dhe nipërit që kanë ikur larg  
në një qytet të madh, të huaj.  
Kullë e braktisur... Një dry te dera  
si hënë e ndryshkur.

*Vrasja e poetit*

Të vranë natën, he i qëlloftë moti  
ata njerëz më të zinj se nata!

Kur të mori plumbi i parë,  
u dogj një pishë në majë të Sharrit.  
Kur të mori plumbi i dytë,  
doli nga varra një tufë pëllumba  
dhe u nis fluturim pér Pejë.  
Kur të mori plumbi i tretë,  
gjaku yt pikëloj mbi botë.  
— Mbrëmë vranë Jusuf Gërvallën!

Kur të dalin gjethet e reja,  
do të ulet qyqja në degë të blirit,  
por s'do të thotë: «Kuku Jusuf!»  
Ti nuk je babë i padjalë,  
as nuk je vëlla i pavëlla.

Sot je vëlla me ata që s'vdesin,  
je vëlla me brezat që vijnë,  
se gjakun tënd ia fale diellit!  
Të vranë natën, he i qëlloftë moti,  
pa i puthur dhe një herë fëmijët,  
pa e mbaruar vjershën e re,  
pa i mbushur dhe një herë sytë  
me re e zogj që vijnë nga jugu,  
pa kafshuar dhe një mollë Peje...

Agimi- që shkrepri mbi dëborë  
kishte kuqëlimin e gjakut tënd.

*Në kështjellën e Krujës*

Kush mund të thotë se këtu  
çdo gur nuk është i çmuar  
dhe nuk ka zë?

Se në faqet e murrme  
nuk ka pikëlime gjaku  
dhe të djegura zjarresh?...

Bari mbin midis gurëve  
si pér t'ua qetësuar plagët,  
si pér t'ua zbutur kujtimet.

Mbështes dorën mbi këta gurë  
dhe ndihem moshatar i tyre,  
njëjtësohem me ta.

Kjo është beja ime e lashtë,  
beja ime në gur  
për liri e truall...

Pavdekësi e gurëzuar,  
tek ti gjej zanafillën  
dhe vazhdimin tim.

*Ruhuni nga e premtja e zezë, popuj!*

Popuj, ruhuni nga e premtja e zezë,  
ruhuni nga shtatë prilli tragjik!...

Mos harroni se para tyre vjen gjithmonë  
e hëna e buzëqeshjeve, e premtimeve  
dhe e shtrëngimit të shpeshtë të duarve,  
e marta e nënshkrimit të traktatit të miqësisë,  
e dollive dhe e fjalimeve solemne,  
e mërkura e huave, e koncesioneve  
dhe e këshilltarëve të huaj ushtarakë,  
e enjtja e ultimatumit njëzetekatërорësh  
dhe e heqjes së gjilpërave nga armët,  
të premten fillon zbarkimi i trupave,  
bombardimi i egër nga ajri dhe, nga deti,  
të shtunën krijohet një qeveri kukull  
me ministra të urtë si pëllumbë,  
të dielën bien këmbanat e së dielës  
dhe hoxhallarët thërrasin nga minaret...

Popuj, ruhuni nga e premtja e zëzë,  
që mund të bjerë në çdo datë të vitit —  
këtë e dinë mirë Praga dhe Kabuli...

Ruhuni nga e premtja e zezë, popuj!

## *Humanizmi i Amerikës*

Amerika është humane, aleluia!

Uitmeni vdiq në mjerim dhe heshtje,

Rozenbergët i vunë në karrigen elektrike,

Hemingueji vrau veten i përndjekur nga policia.

Amerika është humane, aleluia!

Ajo dogji me atom Hiroshimën,

Vietnamin e shndërroi në krater vullkani,

Iranit ia piu gjakun si ujkonjë.

Amerika është humane, aleluia!

Pronarët i kthejnë ushqimet në plehra,

qentë kurohen në klinika moderne,

njerëzit vdesin nga uria dhe sëmundjet.

Amerika është humane, aleluia!

Ajo u jep armë kolonelëve të zinj

të pushkatojnë punëtorët e studentët,

përgatit specialistë për masakra,

Amerika është humane, aleluia!

Presidenti mban fjalime apostolike  
për të mbrojtur të drejtat e njeriut  
dhe jep urdhër të prodhohen bomba me  
neutron...  
Amerika është humane, aleluia!

## *Kuajt e ekspeditës gjeologjike*

Lënë prapa xixëllima gurgaci,  
ngjiten nëpër shtigjet e bjeshkës  
t'u çojnë lëndë plasëse minatorëve.

Diku në këto male janë  
gjurmët e gjokut të Mujit  
e të kalit të bardhë të Bacës.

Janë edhe gjurmët  
e kuajve jelengrirë të partizanëve  
që ngjitën mortaja në bjeshkë...

Ata shkelin mbi këto gjurmë  
me sytë plot tufalakë pishe  
dhe lënë prapa xixëllima gurgaci.

Ngjiten nëpër shtigjet e bjeshkës  
madhështorë si kuajt e legjendave  
dhe të luftërave.

Ngjiten nëpër shtigjet e bjeshkës  
madhështorë si kuajt e legjendave  
dhe të luftërave.

## *Zanat e malit*

Nuse malesh me shtatin prej dritë hëne  
e shkumë ujëvarash, qenie të tejdukshme  
me hapa puhie dhe me fytyrë ëndrrre,  
Barinjtë fillikatë dikur mbushën me ju  
vetminë e pyjeve, vetminë e majëmaleve,  
vetminë e kaltër e të frikshme të netve,  
kur drita e hënës, oshëtima e ujëvarave  
dhe pafundësia e bjeshkëve të ngjethte.  
Sot ujëvarat vërtitin fletët e turbinave.  
buisin sharrat në pyje, sondat në pllaja,  
njerëzit e tanishëm të qytezave alpine  
s'i ngjeth vetmia e pyjeve, e netve të kaltra  
dhe ju shndërrroheni prapë në drita hëne,  
**në shkumë** ujëvarash dhe në puhi **vere**,  
**në** **ëndërr** fëmije që s'mund ta shohësh më,  
në yje që treten në thellësi të netve...

*Në pemëtore*

Të dëgjuan kumbullat kur qeshe  
dhe i hapën burbuqet.

Si të mos çelte lulja e gjëzimit  
në qenien time, moj e dashur,  
nga të qeshurat e tua!

## *L o j a*

Në fillim ishte lojë e patëkeq  
si loja e fëmijëve që ndjekin shoku-shokun  
rreth një pellgu me ujë të kulluar.  
Lojë e syve dhe lojë e fjalëve,  
lojë e gishtave që preken rastësisht,  
lojë e heshtjeve kur ishim bëshkë,  
lojë e përfytyrimit kur ishim larg,  
lojë e ftohjes, lojë e afrimit...  
Papritmas e ndien veten si fëmijët,  
që bien në pellgun rreth të cilit luajtën  
dhe gjuajnë me stërkala njëri-tjetrin.

## *Më erdhi në kantier letra jote*

Më erdhi në kantier letra jote  
si një zog i bardhë me verën në krah.  
Gjithë ditën e mbajta zarfin pa e hapur  
si fëmija që mban një flutur midis duarve  
dhe ka dëshirë t'ia shohë krahët e bukur,  
dhe druhet ta shikojë se mos i ikën...  
Unë e dija që, sapo ta lexoja,  
ajo letër do të mbetej si lëvozhga e thyer  
prej së cilës ka dalë e ka ikur zogu  
dhe e fshehta e bukur që mbante brenda  
do të hapej si kundërmimi prej lules së çelur.  
Një ditë vjeshte kûr po binte shi  
më erdhi në kantier letra jote  
si një zog i bardhë me verën në krah.

## *Flokët e dëborës*

Mijëra flokë dëbore,  
mijëra flokë dëbore  
kaq herë më kanë përcjellë,  
kur jam nisur për udhë  
si sot...

Dhe gjithmonë m'u ka dukur  
se këta flokë dëbore  
në formë ylli,  
që dridhen në erë  
janë duart e tua...

Mijëra flokë dëbore,  
mijëra flokë dëbore  
gjithë rrugës  
prapa më ndoqën...

## *M o l l ë k u q j a*

Në tryezën time plot libra  
një mollëkuqe e bukur erdhi.  
E vura në dorë si në fëmijëri,  
kur i thoshja të më conte në bjeshkë.

Ajo tha se bjeshkët i ka marrë malli  
për hapat dhe thirrjet e mia,  
shpatet janë mbushur me dredhëza të kuqe  
dhe orteku i borës rrjedh pikë-pikë.

Më tha se shpellat e lugjet  
tani atje tundin këmborë të rënda,  
e më tha se në shpinën e ogicëve  
flenë yjet e mëdhenj të mbrëmjes.

Më tha se ájri bie erë qershigél,  
tëbanat kundérmojnë ajkë qumësh,  
e më tha se boçat e pjekura të pishave  
tringëllijnë si kambanëza pas gurëve.

Më tha se delet çojnë kryet përpjetë  
e blegërojnë be-be-beee,  
kur fluturojnë zogjtë mbi to  
dhe retë kalojnë nëpër qìell.

E më tha ta lë tryezën e ngushtë,  
këtë kthinë me zhëg vërrini:  
të mbushen me fllad, me zëra bjeshkësh  
mushkëritë dhe vjershat e mia...

## *Murimi real*

Gruaja s'duhet të mendojë, të flasë,  
s'duhet të qeshë, të këndoja... thoshte kanuni.  
Ky murim brenda heshtjes ishte më i dhimbshëm  
se murimi në themelet e kështjellave, të urave.

Si Rozafa e muruar në kështjellë  
që la përjashta gjirin, syrin dhe dorën,  
gruaja la përtet murimit brenda heshtjes  
të qarat ditën e dasmës, nina-nanat, vajtimet në  
vdektje...

Nëse të gjitha murimet e baladave janë legjenda,  
murimi i gruas brenda heshtjes ishte real, i  
tmerrshëm.

*N è f u sh i m*

Shelgjet përkulen te lumi  
si vashat flokëlëshuara,  
që lajnë të linjtat e bardha  
në këngët popullore...

Pranë shelgjeve të blerta  
vajzat ushtare po krehin  
flokët e tyre të gjatë.

Edhe rrezet e pjerrëta të diellit  
kalojnë si krehër nëpër ta.

Vajza të bukura si floçka,  
trime si nënënat me yll në ballë  
që dje kapërcyen lumenjtë,  
ju jeni shembulli i së bukurës  
dhe i trimërisë së kësaj kohe.

*Imazh i dhimbshëm fëmijërie*

E kërrusur nën barrën e druve —  
kariatidë e shekujve  
dhe e vatrës.

Ecte me flutura të zeza dhimbjesh  
në zemër  
e me lot të gurëzuar te sytë.

Në shputat e çorapëve të fëmijës  
thurte lulet e malit  
dhe krahët e zogut.

E lodhur  
ndalej te një breg i ngritur  
e mbështetëj pas shkëmbit.

Nga ofshama e saj trembeshin zogjtë nëpër degë...

E prapë gishtat e saj të gërvishtur nga shkurret  
thurnin lulet e krahët e zogut  
mbi shputat e fëmijës.

Vështrimi i përhumbur në largësinë e bardhë  
sikur kërkonte këtë kohë —  
kohën e zhdukjes së kariatidave<sup>1)</sup> të gjalla...

Të qeshurat e nuseve  
në rrugën me plepa që shushurijnë  
ma përzënë këtë imazh të dhimbshëm fëmijërie.

---

Kariatidë: statujë gruaje që përdorej në arkitekturë për të mbajtur pjesë të ndërtesës.

## Njerezore

Drurët me borë të pashkundur  
ndanë rruqës zgjatin degët  
si krahë statujash mermari.  
Gomat rrëshqasin mbi akull  
buzë rrëpirash e honesh të errëta.  
Në sytë e menduar të mjekut  
është vizioni i një gruaje që vuan  
në kullën e një fshati të thellë.  
Dritat që luhaten përkundruall  
i ngjajnë me sytë e gruas së panjohur,  
ku flakëza e jetës mund të shuhet...  
Mjeku përkulet mbi trupin e sfilitur,  
shtyn tutje cingërimën e vdekjes,  
shtyn dhimbjen, ankthin, zinë.  
Nata dimërore drithërohet  
nga e qara e hollë e të porsalindurit...  
Nëna ngre qepallat ngadalë —  
bebëzat e saj ndritin si livadhe të vesuara  
në një agim me diell.

Mjeku sheh foshnjën pranë nënës:  
zemra e tij —  
syth që është gati të çelë!

*Nëna dhe djali po ecnin nëpër shi*

Nëna dhe djali po ecnin nëpër shi  
me një çadër të vetme.

Shiu binte me erë.

Nëna ecte nga krahu i erës.

Djali ndiente ngrohtësinë e kraharorit të nënës,  
ndiente ngrohtësinë e pëllëmbës së saj  
që i mbështetet herë pas here mbi shpatull.

Shpatulla dhe ija e majtë e nënës  
ishin lagur nga shiu  
që binte me erë...

Nëna dhe djali po ecnin nëpër shi  
me një çadër të vetme.

## Përsiatja e vreshtarit

Hardhitë zgjatin gishtérinjtë e blertë të bisqeve të  
për të kapur diellin.  
Ti mihi tokën e kuqërrëmtë përreth hardhive,  
thith avullin e bardhë që del nga plisat e çarë,  
thith aromën e mollëve të lulëzuara që për të  
s'mund të gjesh mbiemër  
dhe të duket sikur tërë ditën  
dielli rri mbi supin tënd.

Ti mendon pér burokratin mbyllur në zyrë  
që thith ajër të ndenjur,  
dhe tërë ditën heq vija në një letër të bardhë,  
dhe as që do t'ia dijë pér bisqet e hardhive,  
pér mollët e lulëzuara, pér barin me vesë  
dhe ka frikë nga ngjyra e kuqërrëmtë e plisave  
që mund t'ia ndragë këpucët...  
Ti thua: «I gjori njeri!» dhe buzëqesh vetmevete,  
dhe thith erën e plisave, të mollëve të lulëzuara  
tërë ditën me diellin mbi sup.

*Ai plumb ende vret...*

Sh. Gjeçovit

Zbulove në kodër varret e lashta  
jo vetëm unaza, shpata, vathë e lotore,  
por edhe eshtra të shpuara...

Kërkove rrënjet e besës  
e një ditë kokën ta hëngri pabesia.

Eshtrat e tua që flenë në tokë,  
të shpuara janë si eshtrat e gjyshërve,  
e ne e dimë i kujt qe plumbi!

Një re loton për ty mbi Sharr,  
kupëzat e luleve mbushen me vesë  
si lotore të lashta mbi varrin tënd...

Plumbi që zhibroi ashtin tënd  
ende fishkëllin në hapësirë:

Ai plumb énde vret!

## *Ullinjtë e Ulqinit*

Nën hijet tuaja u shtangën  
legionet me sëpata liktorësh,  
hordhitë me dhëmbin e ujkut  
dhe me hënën e ngrënë.

U kthyen në grumbuj gurvarresh  
si në mítin e zanave...

Në degët tuaja të blerta  
armët prej floriri të trimave  
s'e lanë kohën të përgjumet,  
errësirën e trembën nëpët net,  
diellin e dyfishuan në agime.

Ullinj me gjethe dhe shpata,  
ju gjelbëroni pérherë te syri,  
te zëri i njeriut të kësaj toke  
e te fjala e tij e lashtë sa ju.

*Vallja me pushkë*

**Rugovasit**

Me to në përgjim,  
me to në rrëthim.

Me to në sulm,  
me to në triumf.

Me to përballë vdekjes,  
me to të paepur.

Me to edhe në dasmë,  
me to edhe në valle...

Mbi shtatin e lartë  
pushkët e gjata.

Ata — shkëmbinj,  
pushkët si pisha.

Thuase kanë lindur me to.  
Thuase janë gjymtyrë të tyre  
prej mishi.

## *N d a r j a*

Mirupafshim, det!

Valixhja në dorë,  
diell e kripë në lëkurë,  
kujtime të bucura si guaska deti...  
Dhe po iki tutje.

Por në këpucët e mia  
qenka futur pak rërë —  
ndarja s'qenka e lehtë  
as për rërën...

Mirupafshim, det!

## *Neroni i bjeshkëve*

Kishte treqind dhen,  
këmborët e tyre dëgjoheshin në tri bjeshkë.

Atij i dukej sikur tingujt e këmborëve  
përsëritnin në pafundësinë e bjeshkëve emrin e tij  
dhe bjeshkët tundnin si këmborë jehonën e këtij  
emri.

Sytë e barinje të varfër nxirrnin xixa —  
ato këmborë binin edhe për vdekjen e tyre.

Verë për verë i vinte zjarrin ndonjë pylli  
të zgjeronte kullotat për dhentë e tij —  
ato zjarre ishin dhentë e tij që përpinin bjeshkët!

Ai shihte pishat madhështore që rrroposeshin,  
ahet e bukura që bëheshin hej të zinj,  
mështeknat e dridhshme që fërgëllonin midis  
flakëve...

Ai gajasej si i dehur nga këto zjarre:  
zharet e djegura do të merrnin emrin e tij,  
barin e tyre do ta kullotnin delet e tij.

Treqind dhentë do të bëheshin shtatëqind dhen,  
këmborët e tyre do të dëgjoheshin në shtatë bjeshkë.

Një natë vere ra zjarri në tëbanën e tij:  
era e shkrumbit shkoi larg në shtatë bjeshkë,  
këmborët e shurdhuara mbetën midis hirit...

Sytë e barinjve të varfër nxorën xixa gjëzimi.

*Në kohën e kryqeve*

Kur gatuante bukën nëna ime,  
vizatonte mbi të një kryq të madh —  
mua  
më silleshin në mend kryqet e varreve.

Kur uleshim në sofrën e varfër,  
bashkë me bukën më jepnin një copë të kryqit —  
mua  
më dukej sikur kryqi do të më mbetej në fyt.

Kur më merrte etja gjatë rrugës,  
pija ujë te gurrat e futura në kryqe —  
mua  
më dukej sikur ujit i vinte era vdekje.

Kur ulej muzgu mbi shtëpitë e fshatit,  
vështroja kryqet e drunjta mbi çatira —  
mua  
fshati më ngjante si varrezë e çuditshme.

Kur njerëzit e dëshpëruar hapnin krahët  
me fytyra të ngërthyera nga dhimbja —  
mua  
më dukej sikur ata vetë ishin Krishtër!

Në kohën e kryqeve...

## *Guri murg*

Një gur të bardhë do të kishe te kryet,  
o Prelë Tuli,  
një gur të bardhë pa emër  
për të ruajtur varrin tënd nga bari,  
për të ruajtur emrin tënd nga harresa.

E megjithatë bari do ta mbështillte këtë gur  
e harresa do ta brente emrin tënd,  
o Prelë Tuli...  
Por te kryet tënd koha vuri Gurin Murg,  
ku u gurëzua thyerja dhe turpi i një pashai.

S'është e lehtë të kesh te kryet një mal,  
o Prelë Tuli,  
ku në vend të shkronjave ka gërvishtje plumbash  
që gdhendën mbi shkëmbinj fjalën LIRI  
dhe pranë fjalës QËNDRESË emrin tënd të thjeshtë.

Skulptorët do ta gdhendin në gur shtatin tënd,  
o Prelë Tuli,  
por shtatorja jote e vërtetë është ky mal,  
datëlindja jote e vërtetë është 1910-a  
e ty varrin ta ruan kënga dhe dielli.

---

Te Guri Murg u thye ushtria e Turgut Pashës më 1910

## *Mëngjes nё pyll*

Eci nёpér korridorët e drurëve,  
nёpér dritëhijet e kaltra,  
mbi barin me vesë.

Nuk mund tё shohësh asnje zog —  
vetë drurët sikur këlthasin  
e këndoijnë me një mijë zëra...

Dhe unë përfytyroj atë njeri  
që ka këputur gjethen e parë,  
i ngazëlyer nga këto këngë.

Përjetoj mundimin e tij njerëzor  
për t'i nxjerrë nga fryma e mushkërive  
cicërimat e panumërtta tё zogjve.

Eci nëpër korridorët e drurëve...  
Tani pylli ngjan si zog i çuditshëm  
me flatra të blerta.

### *Armikut tē klasës*

Ti shpif pér mua,  
tē vërtetën time e kthen kokëposhtë.

Kjo gjë më bën ta dua më tepër  
tē vërtetën time  
që ty t'i err sytë.

Pér tē gjitha sukseset e mia  
ti skërmit dhëmbët.

S'më kanë gjuar kurrë buzëqeshjet  
pér sukseset e mia,  
sa skërmitja e dhëmbëve tē tu.

Të pështirë më vjen  
nga ligësia jote.

Tërë jetën do të përpinqem të jem  
edhe më i pastër, më i mirë  
nga neveria për ty...

E di që ti më urren!

## B o r è r a t

Në çdo borë të re që bie  
më shfaqen borërat e dikurshme,  
borërat e fëmijërisë.

Fëmijëria ime, si ato borëra,  
nuk është më...

Po ku është bora e fëmijërisë sime?...  
Mos është bërë fije bari, kallëz gruri?  
Mos është bërë pip shtogu, lule frashëri,  
vile qershie, manaferrë, mollë e kuqe?  
Mos është bërë mjegull për të ledhatuar  
fyturat e ashpra të maleve ku linda?  
Mos është bërë cicërimë në fytin e një mëllenje  
që s'e zë gjumi gjithë natën në prill?  
Apo është bërë avull në faqen e një xhami  
ku shkrova me gisht emrin e një vajze?...

Mos vallë fëmijërinë time duhet ta kërkoj  
te fëmijëria dhe lodrat e tim biri,  
siç duhet të kërkoj te bora që bie sot  
borërat e dikurshme të fëmijërisë?

## *Pushimet dimërore*

Tani qyteti është dhe s'është po ai...

Djemtë dhe vajzat që kanë ardhur nga shkollat  
u japin rrugëve të tij një pamje festë  
bashkë me rënien rituale të borës.

Këto ditë qyteti verior fle më vonë,  
qesh  
dhe ëndërron më shumë...

Tani qyteti është më tepër vetvetja.

### *Lulet e vatrës*

Jashtë erë dhe dëborë.  
Jashtë lule cingërimë  
në degët e drurëve, në strehë —  
të vetmet lule dimri,  
lule kërcënuese si kthetra.

Vatra kuqëlonte si një diell.  
Trungjet e sapoprera në pyll  
digjeshin, lëshonin shkumë.  
Brenda tyre vajtonte një krimb  
(krimbi që kishte brejtur lisin),  
unë s'ndieja keqardhje për të...

Tymi kacavarej mbi trungje  
si fjollë mjegulle, si bisht ketri.  
Mbi to çelnin lule të mëdha flakësh:  
lule të purpurta, të allta, të trëndafiltera

me trajta tē çuditshme si lule ändrre.  
Luhateshin flakët si pëllëmbë tē ngrohta,  
si shami që më thoshnin: Lamtumirë, fëmijë!  
Mua më vinte keq për ikjen e tyre,  
për pamundësinë që t'u shtrëngaja dorën  
a t'u thoshja së paku një fjalë tē mirë.

Trungjet digjeshin, bëheshin prush i kuq,  
vatra kuqëlonte si një diell.

Unë thithja erën e mirë tē drurit që digjej,  
pa u frikësuar nga ulërimat e veriut,  
nga lulet e akullta tē natës dimërore...  
Asnjë lule s'kam dashur në jetën time  
sa këto lule tē kuqe tē vatrës —  
lule që më ngrohin gjithmonë.

## D y d u a r

**Shoferit Azem Madani**

O, duart e tua tē shtrënguara mbi timon!

Duart e tua tē zgjatura drejt jetës,  
tē zgjatura drejt agimit dhe drejt dritës  
si rrugët e gjera tē një kantieri tē madh...

Ato ditë e ato net binte shi me dëborë.  
Binin mbi male shumë pritje e shumë ngazëllim  
ato ditë e ato net.

Lumenjtë e shkumëzuar zbrisnin nga bjeshkët  
si grigja tē bardha me këmborë dallgësh  
dhe sillnin me vete lajme tē reja, tē padëgjuara —  
lajme me vezullime e ngrohtësi dritash...

Tē pafjetura ishin rrugët, makinat  
që rendnin nëpër rrugë

dhe sillnin lëndë ndërtimi për kantieret e Fierzës,  
dhe sillnin punëtorë nga veriu e nga jugu  
ato ditë e ato net.

Ti ishe me duar të shtrënguara mbi timon.  
Boria e zisit tënd si zog i bardhë  
trokiste në dritaret tonë  
ato ditë e ato net.

Ti kishe në sy diejt e njëzet e gjashtë pranverave  
(ashtu si unë)  
e kishe në sy imazhe pranverash që do të vinin,  
e kishe në buzë fjalë të mira që s'arrite t'i thuash,  
e kishe në gishta përkëdhelje të padhëna...

E kishte për pëllëmbët e tua  
kaq duarshtrëngime të ngrrohta shokësh,  
copëra minerali, kallinj të pakorrur, lule të  
pakëputura.

Dhe këngë që prisnin mbi telat e çiftelisë  
kishte për duart e tua...

Ti tani je i téri heshtje —  
Si të gdhendura në strall ngjajnë fytyra jote e qeshur  
dhe dy duart e mëdha që i binin borisë  
në hapësirat e mëngjeseve.

Një ditë do të sillje me makinë të fejuarën tënde  
dhe nëna do të të priste në oborr  
me një kopsht kumbullash të lulëzuara në fytyrë,  
dhe babai me një diell maji në sytë e tij  
do të të priste...

Katër ditë e katër net me duar mbi timon  
përmes shiut, përmes lodhjes, përmes pagjumësisë —  
sytë e tu përmes territ.

Duart e tua të zgjatura si një urë dashurie  
drejt shokut që kishte mbetur në rrugë,  
duart e tua lidhin zemrën me dhimbjen  
e krenarinë me ty...

Duart e tua mbetën të ngrira mbi timon  
në rrugën e gjerë të këtij kantieri të madh.

O, duart e tua të zgjatura drejt dritës!

Sot

telat e çiftelisë ngjajnë si rrugë me dëborë  
ku oshëtijnë autokolonat. Dal në dritare  
dhe dëgjoj si drithërohen hapësirat e mëngjesit,  
dhe e di: atje është patjetër boria jote,  
midis mijëra duarve janë edhe duart e tua  
bashkë me duart e vëllait që mban timonin tënd,  
me duart e shokëve që hapin themelet e digës...

Duart e tua janë bashkë me duart e nënës  
që shtrëngon pranë zemrës letrën e Enverit,  
me duart e nipit që shfleton abetaren,  
me duart e mia që lëvizin penën.

O, duart e tua pranë duarve tonë!

Duart e tua si dy lulëkuqe të çelura  
në brigjet e këtij nëntori.

**1971**

*N j ē f ē m i j ē*

Vështron pértej dritares  
plepat, qiellin e rimtë;  
fytyra e tij e pikëlluar —  
muzg i vrenjtur dimri.

E jashtë është pranverë,  
jashtë cicërojnë zogjtë!

Zëra fëmijësh që luajnë,  
zëra rrëkesh e livadhesh,  
shushurima gjethesh futen  
në dhomën e kyçur nga jashtë.

E jashtë është pranverë,  
jashtë cicërojnë zogjtë.

Bëhen rrëmujë shkronjat e numrat  
si thnegla të trembura,  
fëmijës i dhembin gishtat  
duke shtrënguar penën.

E jashtë është pranverë,  
jashtë cicërojnë zogjtë.

Prindërit mburren për dhjetat,  
për karrierën e tij ëndërrojnë;  
faqja e librit mbufatet  
nga pikat e lotëve...

E jashtë është pranverë,  
jashtë cicërojnë zogjtë.

## POEMA

*E bardha vjeshtë!*

Të fryrë i ke gjinjtë sivjet,  
vjeshta ime e bardhë,  
si ajo nusja e shëndetshme  
që ka lindur binjakë.

Kokrra mollësh të kuqe  
varen nëpër degë,  
kokrra ftonjsh,  
bistakë të bruztë e të praruar,  
kokrra të cara shegësh...

Prej tyre pikon musht,  
gjaku i kësaj toke, djersa ime e kthjellët,  
siç pikojnë qumësht  
gjinjtë e nuses së shëndetshme,  
kur i kapin me duar vogëlushët.

Bulon qumështi yt  
jetëdhënës  
nga kokrra e kallirit të njomë,  
që e shtyp midis dhëmbëve...

Si fëmija që shkrihet në gaz  
duke pirë gji,  
më qesh fytyra sot  
midis frutave, kallinjve,  
moj vjeshtë e bardhë,  
mëndeshë e të gjitha stinëve.

Edhe pëllëmbët e mia,  
edhe sytë e mi,  
edhe zemra ime  
janë kupa të mbushura,  
grunarë të mbushur plot  
me të korrat e tua.



Ti më ke parë dikur,  
e bardha vjeshtë,  
duke i numëruar dhimbjet e mia  
me gjethet e tua të verdha.

Ti më ke parë dikur  
duke i numëruar lotët e mi të hidhur  
me pikat e shiut tënd të ftohtë  
që qullnin supet e mia,  
supet e kërrusura të kohërave.

Ti më ke parë dikur,  
vjeshta ime e bardhë,  
duke i krahasuar ëndrrat e mia  
me zogjtë e tu të lagur e të mardhur,  
që klithnin e zhdukeshin në muzg.

Kështu klithnin nëpër vite  
ëndrrat e mia të shuara!...

Vjeshtë, vjeshtë e bardhë,  
s'më pate ngopur kurrë me ëndrra,  
s'më pate ngopur kurrë me bukë.

Por ti nuk ishe fajtore,  
as shiu yt nuk ishte,  
madje as vetëtimat dhe rrufetë e tua  
që digjinin horizontet  
dhe copëtonin qiejt,  
fajtore nuk ishin...

\* \* \*

Drithërat thithin lëngun e tokës  
e bëjnë bukë.

Pemët thithin shira e rreze  
e bëjnë fruta...

Ti,  
vjeshta ime e bardhë,  
thithe gjakun që derdhën shekujt  
dhe bëre festa të kuqe —  
festa që rrezëllijnë midis ditëve  
si lulëkuqe ndër grunjëra...

28 Nëntori —  
Dita e Flamurit,  
vetëtimë e kohërave.

8 Nëntori —  
Themelimi i Partisë,  
farë e gjithë të korrave.

29 Nëntori —  
hark triumfi  
me ëndrrat e dëshmorëve...

Mbi këtë tokë të përtërirë  
sa gëzime do të reshje  
moj vjeshtë e bardhë,  
stinë e kongreseve!

Do të mugullonin  
në hapësirat e ditëve  
drurë të blertë, madhështorë:  
festa e poezisë,  
festat e uzinave,  
festat e vjeljeve e të korrjeve,  
Festa e Dritave...

Festa të reja  
do të lindin nesër,  
por rrënjet e gëzimit  
te gjaku i të rënëve  
gjithnjë do t'i kesh,  
gjithnjë do t'i shtrish,  
e bardha vjeshtë.

Te mendimi i ri,  
te djersa e kthjellët,  
tek ëndrra e bukur  
rrënjet do t'i kesh...

Rrënjet e tua —  
rrënje sulmesh, betejash,  
rrënje drithërash, hardhish,  
rrënje dritash, poemash  
gjithnjë do t'i kesh  
te viti '41, te muaji nëntor  
dhe te data 8.

Stina ime gazmadhe,  
e bardha vjeshtë!

\* \* \*

Gështenjat kanë hapur eshkat,  
sikur thonë: Eja na mblidh!  
Sikur më buzëqeshin.

Kokrrat e arrave më bien mbi supe,  
sikur më qëllon dikush miqësisht  
e më thonë:  
Eja na mblidh, o i lumtur!

Mollë të verdha,  
mollë të kuqe  
si mijëra hëna dhe diej  
midis degëve ndriçojnë,  
përflakin muzgun.

Nga kumbullat e pjekura, të kaltra  
fshatrat kundërmojnë  
mjaltë  
dhe lëmenjtë e drithit,  
si lëmenj dielli,  
zbardhëllojnë midis arave...

Në shtëpitë e gurta  
mushti i rrushit zien,  
zien mushti i kumbullave.

Dolli dasmash  
gurgullojnë brenda tyre,  
vjeshta ime e bardhë.

\* \* \*

Ti e sheh që po qesh,  
siç qesh në degë një shegë e çarë —  
gazi më vërshon nga zemra,  
nga buzët e nga sytë,  
moj vjeshtë e bardhë.

Po, vjeshtë, nuk ta fsheh:  
shkak je edhe ti,  
shkak  
është edhe kjo vajzë!

Ka këputur dy kokrra rrushi të zi  
nga bistakët që vjel në vreshtë  
dhe i ka vënë në sy.

Ka këputur dy mollë të kuqe  
nga dega më e lartë  
dhe i ka vënë në faqe.

Ka këputur  
një mëngjes me diell  
dhe e ka vënë në buzë...

O vjeshtë, vjeshtë e bardhë,  
zemra ime bëhet zog,  
kur e takoj atë vajzë!

\* \* \*

Mbrëmë po viaj nga fusha.  
Bistakët e yjeve vezullonin në qiell  
si bistakë rrushi  
dhe kulloshtër drite pikonte  
Udha e Qumështit...

Mbrëmë pashë në një brinjë  
dy hije të kërrusura:  
një burrë dhe një fëmijë.

Burri mbështetej te fëmija  
dhe diçka i pëshpëriste,  
diçka të padukshme  
i tregonte me gisht.

Burri që pëshpëriste në muzg  
i tregonte të birit ish-pronën e tij,  
vendin e sinorëve të shkulur.

Mundohej të ngulte prapë  
në vetëdijën e fëmijës  
hunjtë e zinj të gjerdheve,  
gurët e kufijve...

Po, vjeshta ime e bardhë,  
ende s'janë tharë rrënjet e vjetra të pronës,  
ato énde mbahen  
si rrënjet e ferrave të prera  
që fshihen nën tokë, —

Por ne s'i harrojmë.

Po të ngriheshin prapë nga toka  
gurët e kufijve të vjetër,  
do ta helmonin pjellorinë tënde,  
lumturinë time do ta nxinin  
gurët-lugetër...

Por ne s'i harrojmë,  
ne nuk flemë.

S'i harrojmë kurrë  
pishtarët e kobshëm që na dogjën të lashtat,  
shojet e ushtarëve të huaj.

S'e harrojmë kurrë  
mundësinë e kthimit në lugetër  
të sinorëve të dikurshëm...

Ne nuk flemë.  
ne të ruajmë ty  
*si nëna që ruan ferishten* në djep,  
si qerpiku që ruan syrin,  
e bardha vjeshtë.

\* \* \*

Ndiej si rritet çdo ditë,  
vjeshta ime e bardhë,  
kjo pemë e re për ty.

Poemë e ngarkuar  
me mollë e rrush,  
me lëmenj plot drithë,  
me vargje që pikojnë musht.

Poemë me dolli dasmash,  
me të qeshura nusesh...

—

Shtohen vargjet  
si kokrrat e mollëve,  
si lëmenjtë e drithit  
strofat shtohen.

Gëzimin e ditëve të tua,  
pjellorinë tënde  
nëpër to e mbledh.

Edhe e qeshura e një vajze  
(thelë e sapoprerë molle)  
aty është patjetër.

Vargje të reja mugullojnë  
në zemër, në buzë  
siç mugullojnë në ara  
farat e reja të grurit...

Të pafundme janë gëzimet tonë  
si të korrat në arë,  
si bistakët në vreshtë.

E pafundme është poema jote,  
e bardha vjeshtë.

1982

## Z è r a t

As tinguj brirësh majë ledheve, as zëra njerëzish  
te dyert

nuk e lajmërojnë këtë mesditë ardhjen tonë  
te kjo qytezë e lashtë e mikpritëse ku dikur  
bujtën karvanarë, fyelltarë dhe aedë... Ajmë!

Vetëm heshtja rri pezull mbi gurët e ledheve të  
rrënuara,  
mbi shkëmbinjtë, lisat dhe barin, mbi planimetrinë  
e shtëpive  
te kjo qytezë e lashtë, e vdekur... Qytezë pa dyer.

As tinguj brirësh majë ledheve, as zëra njerëzish  
te dyert...

Mure të shembura, troje dhe vatra me myshk e  
me bar.

Këtu shkelën dikur shputat e buta të njerëzve  
që u kthyen të lodhur nga puna a nga lufta.

Këtu u dashuruan, u puthën, lindën fëmijë... O, më  
jehojnë në vesh të qarat e të sapolindurve!

Këtu bënë ksodhin e gjyshërve dhe të etërve të vdekur.

Këtu qeshën dhe qanë, provuan çaste dëshpërimi dhe triumfi...

Tani rriten vetëm lisa të mëdhenj e të moçëm, me rrënje të mbërthyera si kthetra midis gurëve dhe hardhjet rreziten në diell — nën po atë diell që e panë sytë e atyre që s'janë më!

Te këta lisa majë kodrës, në fund të qytezës u ranë brirëve për dasma, për të kremtuar ditën e Panit,

në netët me hënë u ulën të rintjtë e dashruar, fërgëlluan nga pëshpërimat e erës dhe nga drita e hënës. —

O, si të mos dëgjosh pshëretimat, fjalët, të qeshurat dhe rrahjet e zemrave të tyre!

Me degët e gjelbëruara të lisave të dikurshëm këtu kurorëzuan ballin e përgjakur të trimave, kurorëzuan fyelltarin më të mirë, aedin që këndoi poemën më të bukur...

Ku janë zërat e tyre, ngazëllimi i syve, duartrokitjet? Të gjitha janë tretur në ajër, te kjo heshtje mesdite siç treten bubullimat e vetëtimat e një shtrëngate të madhe,

ngjyrat e ylberit dhe pikat e shiut që bien nga  
gjethet tek avujt e tejdukshëm që ngrihen nga toka, te  
retë e bardha.

As tinguj brirësh majë ledheve, as zëra njerëzish  
te dyert...  
Qytezë e lashtë, e pagojë... gjithçka mund të heshtë,  
por s'mund të heshtë pér asnje çast nata jote  
e fundme,  
s'mund të heshtin tingujt e vonuar e të kotë të  
brirëve,  
pasi dyert e forta prej bungu qenë hapur... Ajmé!  
Tashmë pishtarët e armikut po digjin shtëpitë,  
burrat rrëmbenin përgjumësh shpatat, heshtat,  
mburojat,  
gratë rendnin jashtë flokëlëshuara me foshnjat në  
duar.  
Shtëpitë rroposeshin, të vrarët mbeteshin në ledhe —  
O, ç'rrapëllimë skëterre te kjo natë që të djeg  
bebëzat!

Një pitos i lashtë, i mbushur me grimca të zeza —  
grurë i bërë thëngjill që s'arriti kurrë të bluhet,  
farë që s'njohu gëzimin e të mbirit, farë e shndë-  
ruar në mumje...

Megjithatë prapë u gjet dikush që bashkë me  
fëmijën  
shpëtoi nga djegia edhe pak farë gruri,  
për ta hedhur në arë kur të vinte koha e mbjelljeve.  
Një shigjetë e ndryshkur, si e mbështjellë me gjak  
të mpiksur...

Ja, trupi i shtrirë përtokë si përpëlitet nga dhimbjet,  
me këtë shigjetë të ngulur diku në kraharor a në  
shpatull,  
currili i gjakut të ngrohtë rrjedh nga varra  
tinëzisht. —

O, si mund të mos e dëgjosh në heshtjen e kësaj  
mesdite?!

Qytezë e lashtë, e rrënuar, disa herë kam ardhur  
te ti  
duke thënë me vete: Po shkoj të rri pak me  
gjyshërit!

Dhe nuk e di pse ndiej mall të të shoh nganjëherë,  
të ngjitem në majën e lartë të shkëmbit ku je  
mbështetur,  
ku djem dhe vajza të kohës sime kanë gdhendur  
emrat e vet  
jo si epitafë, por si në një regjistër të gurtë lindjesh.  
Qytezë e lashtë, e rrënuar... në njëfarë mënyre edhe  
ne jemi banorët e tu!

Kam ardhur të vë dorën te muret me gurë të latuar,  
të tremb hardhjet që rreziten, gjarpërinxjtë kalimtarë

(kurrsesi kjo qytezë s'mund t'u përkasë vetëm  
zvarranikëve!)

të dëgjoj zogjtë e dashruar që këndoijnë nëpër degë —  
seç ka diçka të veçantë kënga e tyre mbi këto rrënoja!  
Të dëgjoj të fshehtat e dhimbshme të gurëve...

As tinguj brirësh majë ledheve, as zëra njerëzish  
te dyert...

Qytezë e shkretuar që hesht, pa ty  
diçka do t'i mungonte kësaj hapësire dhe kohe,  
fshatrave me shtëpi të bardha midis kumbullave të  
lulëzuara,  
ku ngjitet tymi i kaltër nga vratat e ndezura,  
fushave të mbjella me grurë, vreshtave që mbulojnë  
kodrat  
dhe qytetit të ri atje tej me pleq e fëmijë,  
me rrugë të gjera, sheshe, statuja dhe tymtarë  
fabrikash...

Qytezë e lashtë, e rrënuar... heshtja jote  
oshëtin brenda nesh si një kor i lashtë tragjedie,  
porosi që shpërthen nga gurët e përcillet nëpër kohëra:  
Ata që rrënojnë qytete dhe vërsulen natën mbi ta  
ende nuک janë zhdukur, ende kërcënojnë qytetet që  
flenë  
me pishtarë të rinj, më të tmerrshëm!

*Vallja e flakëve*

**Bytyqit e Borovës  
që i dogjën nazistët**

Flakët duan ta djegin zërin tim,  
ninullën time te djepi,  
biri im i vogël —  
zog dashurie dhe jetë.

Kreshpérohen flakët,  
rreth meje ulërijnë,  
por zërin tim s'mund ta djegin,  
biri im!...

Po ia lë zërin tim ahut  
ta bëjë bisk të gjelbër.

Po ia lë zërin tim flladit  
ta bëjë pëshpërimë gjethesh.

Po ia lë zërin tim kroit  
ta bëjë fiskajë të bardhë  
e t'i njomë buzët e tua të rreshkura,  
o biri im i vogël —  
zog i djepit të djegur.

Po ia lë zërin kohës sime  
të mos jetë kohë pa zë.

Po ia lë zërin tim erës së malit  
të flasë me ty, vogëlush,  
t'i flasë kohës sate...

O, zëri im që bie erë shkrumb!

\* \* \*

Ata erdhën në të gdhirë.

Mbaje mend:  
ata erdhën tinëz, biri im,  
kur njerëzit po shihnin èndrrat e fundit  
të atij mëngjesi.

Èndrra të thjeshta e njerëzore  
si èndrrat që shihja unë për ty:  
duke të vënë pushkën e gjatë në krah,  
duke të nisur me dhen te bjeshkët me borë,

duke tē përqafuar ditën e dasmës sate,  
biri im i vogël.

Përditë tē përkundja e ëndërroja,  
e përditë tē këndoja te djepi:

Θ nina-nin djepin me sanë,  
ti m'u rritsh si bima në arë!

Nin-nino djepin me dushk,  
tē martoftë nëna me njëqind krushq!...

Të përkundja, bir, e tē këndoja  
dhe kulla e gurtë oshëtintë nga djepi yt,  
dhe kulla e gurtë qante e queshte me ty,  
dhe unë tē rrija te kryet e djepit  
    me një ninullë tē re në buzë —  
ëndërroja pér ty, zemëro,  
si tē gjitha nënët  
    që përkundnin djepet në kulla.

\* \* \*

Mbrëmjeve  
mbi kodrat e rrumbullakta ngrihej një hënë e kuqe  
si e lyer me kënà.  
Vajzave tē reja

u mblidhesin në cep të syrit bula lotësh.  
Në bistakët e pjergullave fryhesin kokrrat e rrushit  
dhe në degët e përkulura kuqeshin mollët —  
mollët kuqëlusha si faqet e tua, biri im.  
Nënave dhe etërve u sillej në kraharor  
një zog i hutuar gjëzimi,  
si zogu i mbyllur në kthinë që kërkon dritaren...

Po vinte stina e të korrave,  
stina e dasmave.

Në oborret dhe pragjet e kullave prej guri  
të moshuarit mprihnin drapërinjtë  
me sy të mbushur me tymnajë luftërash,  
me sy të mbushur me lëmenj e sofra,  
me sy të mbushur me pishtarët e ndezur të  
dasmave,  
me sy të mbushur me shamitë e valles së brumit,  
të valles së gojfilit e të valles së sokolave.

Të moshuarit mprihnin drapërinjtë  
që vezullonin në duart e tyre si hënëza të reja,  
si krahe lejlekësh në fluturim.

Djemtë e tyre luftonin në male,  
biri im...

Mprihnin drapërinjtë të moshuarit:  
donin bukë djemtë që luftonin për lirinë,  
për ëndrrat  
dhe për dasmat e kullave.

Donin kulaç të grunjtë dasmat  
që ta ndanin bashkë dhëndri dhe nusja  
ditën e parë të martesës,  
sikur të ndanin midis tyre  
një diell.

Donin dasma kullat tona të lashta  
të mos mbinte bari në pragjet e gurta,  
të mos pushonte në to përkundja e djepeve,  
të mos mbulohej zjarri me hi,  
të mos mbeteshin pushkët e varura pas dere,  
biri im, biri im.

Stinët e kullave tona  
nuk mbetën kurrë  
pa të korra dhe dasma...

Djemtë luftonin,  
të moshuarit mprihnin drapërinjtë  
nëpër oborre dhe pragje.

Dhe hëna e kuqe  
mbi kodrat e rrumbullakta ngrihej në mbrëmje  
si e lyer me kënà —  
sytë e vajzave të fejuara mbusheshin  
    me një ndriçim të dridhshëm  
si dritë hëne,  
brenda kurmit u gurgullonte një gëzim i drojtur  
dhe në faqe  
u pikonin bula lotësh.

Ato u linin lamtumirën bjeshkëve ku kishin  
    veruar,  
erës që fishkëllin në pisha, gurrave, gjollëve  
dhe shamitë e bardha e të verdha silleshin rreth  
    tyre  
si fluturat rreth pemëve të lulëzuara...

Zemra e tyre dridhej si defat që binin,  
si hëna mbi ujëra.



Një javë më parë, biri im,  
ishte martuar Sokoli, djali i Ujkanit,  
që ua prishte mendjen bareshave  
    me fyellin e tij.

O, si oshëtinte atë ditë fshati, si oshëtinin  
kullat e gurta midis mollëve  
kur u nis vargani i krushqve  
për të marrë nusen e Sokolit!

Krushku i parë  
mbante në dorë flamurin kuqezi  
me një mollë të madhe, të kuqe në majë të shtizës.  
Pas tij vinte ogici me brirë të gjatë e të dredhur  
me dy mollë të mëdha e të kuqe në majë të  
brirëve.

Me fytyrë të qeshur, të mbuluar me djersë,  
lodërtari i binte tupanit  
dhe të dukej sikur po i binte vetë diellit,  
që ishte ngjitur mbi kodrat e rrumbullakta  
    me bush e shqeme të kuqërrrema,  
ku fluturonin kryeartëzat e grizhlat  
e pëllumbat e egër...

Sokoli ndenji me nusen vetëm tri net.

\* \* \*

E la tufën e dhenve e fyellin,  
e la nusen në kullë,  
u ngjit në male ku luftonte ati yt  
dhe vuri në ballë yll të kuq,  
biri im, biri im.

\* \* \*

Ata erdhën tinëz atë mëngjes,  
e rrëthuan fshatin tonë që po flinte  
dhe mbante vesh krismat që vinin nga malet,  
siç dëgjon të rrahurat e forta të zemrës së tij  
njeriu që pret dikë të dashur.

Shihte në ëndërr atë mëngjes fshati ynë  
vetëm lirinë duke ardhur mbi kalin e maleve  
si një nuse,  
vetëm lëmenj e dasma  
dhe shumë djepë që tunden, biri im.

Ata kishin të gjithë helmeta dhe kryqe,  
lëviznin nëpër mugëtirën e agsholit  
                              si një varrezë e shkulur,  
sikur mbanin në kraharor kryqet e varreve të tyre.

Ua vunë zjarrin kullave tona tē lashta  
njerëzit me kryqe dhe automatikë tē zinj...

Dhe kullat tonë u ndezën,  
o bir, të gjitha kullat e fshatit morën flakë  
si pishat kur i gjuan rrufeja!

Ne shikonim tē shtangur atē valle flakësh  
që kreshpérohej rrëth nesh,

vërshonte e ulerinte nëpër lagje  
si kuçedër që përpinte drithëra, pemë, shtëpi,  
njerëz...

Shikonim përmes flakëve, biri im,  
ushtarët që na vështronin gjakftohtë  
me skërmitjen e ujkut  
dhe me sytë e orlit!

\* \* \*

### Lodërtari

u hodh nga kati i dytë i kullës së ndezur,  
duke marrë tupanin me vete.

Lodërtari nuk kishte fëmijë  
dhe gjënë më të dashur kishte atë tupan,  
biri im.

Vrapoi lodërtari nëpër kopshte, ara e përrenj  
me tupanin krahëqafë,  
duke i rënë aq fort sa s'i kishte rënë kurre  
në asnje dasmë,  
duke i rënë e duke vrapuar,  
duke vrapuar e duke i rënë:  
Hej, zgjohuni, zgjohuni, zgjohuni!  
Thërriste tupani i tij  
në atë mjegullinë agsholi.

I binte tupanit lodërtari  
dhe rreth tij kreshpërohej  
kuçedra shumëkrerëshe,  
vallja e kobshme e flakëve...

Ata e qëlluan lodërtarin majë një kodre  
me bush e shqeme të kuqërrrema:  
lodërtari u rrëzua, ra në ije  
me tupanin që i varej krahëqafë si një diell. —  
Currila gjaku rrodhën nga plagët e tij,  
rrodhën nga të çarat e tupanit, të shpuar  
si currila gjaku tingujt e valleve  
në hapësirën e atij mëngjesi.

Ata e vranë lodërtarin  
që ta digjnin tërë fshatin tonë,  
të digjnin èndrrat, vallet, fëmijët...  
Të digjnin dasmën tënde,  
dasmat e moshatarëve të tu,  
biri im, biri im!

\* \* \*

Ata erdhën në të gdhirë...

Rrezet e para të diellit që ranë atë ditë  
u ngatërruan nëpër flakët e kuqërruara,

u bashkuan  
me zinë e shkrumbit, të thëngjive, të hirit.

Dita u bë natë nga tymi i zi,  
nata që erdhi pas saj

u bë ditë nga flakët:

o bir, tymi u ngjit deri në qiell,  
u ngjit flaka në majë të malit!

U përcëlluan xhufkat ngjyrë vishnje të misrave,  
u përthanë kokrrat në veshulët e pjergullave,  
mollët e kuqe u nxinë  
e ranë nga degët,  
ikën të tmerruara kryeartëzat, grizhlat e  
pëllumbat e egër

nga çerdhet e drurët,  
ikën bletët e trembura nga zgjojet,  
ikën bulkthat nga arat,  
iku Roja e Trollit nga kullat,  
iku gjithçka që ishte e gjallë e që mund të lëvizte,  
për të shpëtuar nga flakët.

Ikën, ikën, ikën...

Megjithatë shumë vetë u dogjën, biri im,  
u dogjën vajza që s'arritën të bëhen nuse,

u dogj paja e tyre,  
u dogj nusja e Sokolit me një javë nusëri,  
u dogjën nuse që prisnin foshnjat e tyre,  
u dogjën këmisha të vogla e djepe fëmijësh,  
u dogjën magje, fyej e lahuta,  
u dogjën drithërat që s'arritën të bëhen lëmenj,  
u dogjën parmenda e doreza drapërinjsh  
nga ato flakë që më ndanë prej teje;  
biri im, biri im!



Ata ikën duke lënë prapa klithma,  
duke lënë prapa gjak të mpiksur mbi gurë,  
duke lënë prapa oborre dhe ara të nxira  
dhe mendonin — siç menduan të gjithë ata  
që erdhën këtu  
me urë në dorë —  
se prapa tyre do të mbetej vetëm kuja,  
zia  
dhe hiri i ftohtë.

Ata mendonin se do të iknin  
ashtu siç erdhën:  
të pathyeshëm,  
të tmerrshëm...

Te kodrat e rrumbullakta, biri im,  
pushkët e partizanëve i qëlluan  
në krahapor e në kryqe  
dhe ata gjetën këtu  
vdekjen e tyre.

Ende pa u shuar flakët,  
pa u ftohur ènde hiri i nxehtë,  
jeta e fshatit tonë mugulloi prapë  
si një pyll i ri  
që mbin mbi hirin e një ahishteje të djegur.

Njerëzit grumbulluan trarë e gurë të latuar,  
hapën themele dhe bënë llaç,  
ngritën mure të reja ndanë rrënojave  
e lanë dyer me harqe për të pritur miqtë,  
e lanë shumë dritare për të hyrë dielli,  
lanë edhe frëngji për të qëlluar dushmanin  
ngado që të vinte...

Në pranverë mbi hi mugulloi bari,  
në arat e mbjella mbinë drithërat,  
në hardhitë e moçme biskuan lastarët,  
shpërthyen lule në pemët e zhuritura.

Në qiellin e fshatit brofnin dallëndyshet,  
prisnin me gérshërët e bishtit të tyre  
shiritat e ylberëve.

Fëmijët prisnin degë shelgu e bënин bilbila,  
ndiqnin në fusha  
fluturat e bardha e të verdha  
dhe nga të qeshurat e tyre oshëtinte fshati,  
bleronte e çelte lule zemra e njeriut  
që kishte kapërcyer vdekjen!

\* \* \*

Partizanët erdhën nga malet  
dhe fshati u mbush me yj të kuq,  
u mbushën vatrat me fjalët dhe të qeshurat e tyre  
si një pyll ku gurgullojnë rrëketë  
një mëngjes prilli.

Yt atë të kapi në duar  
e të ngriti hopa.  
Pata frikë mos të përplasej kryet në qiell,  
kaq lart të ngriti, o bir,  
e ti qeshje, qeshje!

Të rroku e të puthi aq shumë yt atë  
atë ditë.  
Unë e dija se ai të rrokte e të puthte,  
të puthte sytë, ballin, flokët  
edhe për mua, vogëlush...

\* \* \*

Biri im, bima e zemrës sime,  
sa shpejt m'u ngrite në këmbë,  
sa shpejt që m'u rrite!

Ti dëgjoje fëmijët e tjerë që thërrisnin: Nënë!  
Vraponin te krahët e hapur të nënave,  
uleshin në prehër të tyre  
dhe fjala «nënë» të përpëlitez në buzë,  
dhe kishte një heshtje të papritur  
midis lojërave të tua, vogëlush.

Por ti më ke pasur pranë teje çdo çast,  
po aq afër sa dhe gjakun në deje,  
po aq afër sa dhe hijen tënde  
kur ecje këmbëzbathur nëpër barin me vesë,  
kur lëkundeshe me shokët në shilars,  
kur mblidhje në bjeshkë rruaza ahu e dredhëza,  
kur gjuaje me topa bore e të kuqeshin faqet  
dhe kur hukatje duart e mardhura, o bir,  
duke shkuar në shkollën e vogël  
përmes erës së dimrit...

Jam gjëzuar me çdo gjëzim tëndin,  
jam trishtuar nga çdo trishtim yti,  
jam rritur me eshtrat e tua,

kam ecur me hapat e tu,  
kam parë me sytë e tu  
dhe kam qeshur me buzët e tua,  
biri im, biri im.

Të kam përcjellë e fundit  
kur je nisur për në shkollën e lartë.  
Të kam pritur si drurët midis erës dhe shiut  
te kodrat e rrumbullakta  
dhe të kam përqafuar e para kur je kthyer,  
biri im sydritë!  
Mollët kuqeshin në degë.  
Bujqit mprihnin drapërinjtë  
nëpër oborre dhe pragje.  
Kullat e gurta oshëtinin  
nga tupanat e dasmave,  
shamitë e bardha e të verdha  
dridheshin në erë  
dhe hapat e dasmorëve rrıhnin truallin  
në vallen e sokolave,  
në vallen e gojfilit e në vallen e brumit...

Biri im,  
natën e dasmës sate  
në sofër ka qenë një vend i pazënë  
dhe në rrethin e valles  
ka pasur një hapësirë të zbrazët

për duart e mia  
dhe kanë qenë atë natë duart e mia, biri im,  
në të gjitha vallet që u kërcyen.

\* \* \*

Biri im syzgjuar,  
biri im i madh:  
ende s'ka pushuar në botë  
vallja e flakëve.

Vallja e flakëve që dogji fshatin tonë,  
trupin, fytyrën dhe duart e mia  
mbi tokë vërtitet,  
vërtitet mbi detra...

O, prushi i tyre  
prapë m'i djeg eshtrat!

Biri im, ende bredh nëpër botë  
njeriu me kryq e automatik të zi,  
njeriu me skërmijen e ujkut  
dhe me sytë e orlit.

Ai mund të buzëqeshë, biri im,  
edhe ty mund të të buzëqeshë,  
në buzëqeshjen e tij është vezullimi i flakëve,  
hiri dhe ashti i djegur...

Por unë nuk jam vetëm hi,  
megjithëse kam një grusht zjarr  
në vend tē mollëzave tē mia.

Nuk jam klithmë e largët  
që humbet nëpër vite.

Biri im, zëri im,  
zëri i një kohe  
që s'mund tē digjet.

Biri im,  
lastar i jetës sime.

*Me kulmin te dielli*

I

E kam ngritur Kullën time në këtë skaj të Evropës  
majë maleve, midis grykave, ndanë deteve,  
të gurtë e kam bërë të mos e shembin stuhitë,  
gjer te Dielli e kam ngjitur të mos humbë në mjegull,  
thellë në shkëmb e kam ngulur të mos e lëkundin  
erërat që dynden  
në këto mote të sarta....

Në tokën time ndrit koha e Diellit,  
çel në bebëzat e mia lulen e madhe të dritës,  
çel lulen dhjetëpetalëshe të duarve të mia,  
çel lulet e drithërave,  
çel lulet e zjarrrta të metaleve, lulet e kaskadave,  
lulet e dashurive, lulet e qëndresës  
dhe lulet e breznive

të mbushet trualli im me gjelbërimin e të mbjellave,  
me të korra dhe gëzime të mbushen stinët.

Rreth Kullës sime vërtiten lukunitë e erërave,  
ulërijnë, hakërrohen, buzëqeshin...

Por derën time erërave ua kam mbyllur,  
erërave të acarta dhe erërave të thata,  
të mos hyjë tek unë gërryerja e tyre,  
të mos hyjë rrëmuja dhe makthi.

Erërat e kanë ndërruar shpesh vrullin e drejtimin,  
kanë ndryshuar ftyrat e emrat e zërat,  
por unë ua kam mbyllur derën e Kullës sime,  
mbyllur ua kam që në vitet '44 —  
i kam lënë hapur dritaret e vitet e mia  
vetëm për frymën e dëlirë të popujve...

Kulla ime — tëbanë e Diellit,  
tëbanë e shpresës dhe shtrojerë e gëzimit,  
vështron gjakftohë kërleshjen tragjike të erërave,  
zembraps cingërimën dhe djegagurin e tyre,  
mohon arkitekturën mortore të akullnajave e të  
dunave  
dhe vërshon rreze Dielli nëpër stinët e botës  
Kulla ime e stralltë,  
Kulla ime me themele gjaku,  
Kulla ime me mure trimërie dhe bese  
e me kulmin te Dielli.

Erërat vërshojnë mbi qiejt dhe çatitë e botës,  
 hyjnë e dalin nëpër dyert e shteteve  
 me vrингëllima armësh e kërcëllima nofullash,  
 gllabërojnë pyje, drithëra, minerale, naftë,  
 vjedhin muskujt, gjakun dhe trutë e njerëzve  
 erërat pretare të dyerve të hapura...

Fryjnë e shfryjnë erërat, cirren, gjëmojnë, kapërt  
 thehen  
 të ndërsyera nga shqetësimi nervoz i kohës,  
 i kësaj kohe të rrrolur, me re, me rrebeshe.

Fryn era që pandeh se vran e kthjell, era  
 që djeg e rropos,  
 fryn era e dalë bese,  
 era që shpërndan farë kafkash, farë mashtrimesh e  
 mynxyrash,  
 era fqinje që gërvallet në patalokët e viteve  
 si lolo me fytyrë të ngërdheshur nga tërbimi...

Kulla ime përballë erërave i njeh mirë erërat,  
 nëpër shekuj ka provuar pabesitë dhe kobet e tyre.  
 Ka parë rrrotull saj tymtajat dhe flakadanët e erërave,  
 orgjitet e përgjakshme mbi trupin e kombeve,  
 mbi trojet e vjedhura, mbi rënojat e shteteve.

Kulla ime ka parë vatra të fikura  
që dyert i hapën dhe i mirëseardhën erërat.

Kulla ime ka parë kulme të rrëzuara  
që u përgjunjën para dhunës së erërave.

Kulla ime ka parë kombe gjakhumbura  
që besuan në besën e erërave.

Kulla ime e stralltë ka sfiduar  
kafshimet e kobshme të erës së dalë bese.

Kulla ime me kulmin te Dielli  
shumë erëra ka parë...

### III

Frymë e Kongresit XX,  
retë e kundërrevolucionit mbulojnë qielin sovjetik  
dhe perëndon Dielli mbi Moskë,  
nën kupolat e Kremlinit vezullon kafka e Hrushovit  
si maska e lyer me grim e një loloje  
dhe dy ikset e Kongresit të Njëzetë si gërvshërë  
vigane  
presin shiritin e zi të përrurimit të tradhtisë,  
zhdukan kufirin midis të kuqes e të bardhës...

Dy ikset e Kongresit të Njëzetë si kocka të  
kryqëzuara  
dhe sipër tyre kafka e lëmuar e Hrushovit —  
shembëllim i globit të mbuluar nga akullnajat e  
dëbiora.  
Përballë Kongresit XX — Enveri me grushtin e  
shtrënguar,  
me krismat e revolucionit në zërin e tij,  
mendimet e tij të patundura si vargmalet,  
barrikada të pakapërcyeshme përballë tradhtisë.  
Shkëlqejnë nëpër natë katedralet si llambadhe të  
ndeitura  
për rekuiemin e amshueshëm të revolucionit,  
gjëmojnë kambanat e Moskës  
si kambanat e Natës së Shën Bartolemeut...  
Ngrihet zëri i Enverit më lart se kambanat  
dhe altoparlantët e Moskës:  
Ikset e Kongresit XX janë kryqe të thyera,  
rrezik i madh,  
tradhti e madhe, popuj!

E dëgjojnë popujt  
dhe lumenjtë e rrudhave vërshojnë në ballin e tyre  
si Vollga dhe Rini, si Nili dhe Amazona dhe Misisipi  
të mbushura me dallgë të shkumëzuara zemërimi...  
Frym era siberiane me mijëra kambana kishash në  
qafë,

era që tallet me shamitë e zeza të nënave,  
me vajzat dhe me djemtë e lavdishëm të nënave,  
era që lëviz së prapthi akrepët e orëve,  
që shpalos së prapthi historinë  
e u shkim hisen e diellit popujve.

Hingëllin nëpër hojzat e topave dhe brirët e paqes  
era që zhvarros të dënuarit nga revolucioni,  
kufomat e tyre i kthen në statuja,  
statujat e heronjve i bën copë-copë,  
i vë flakën në errësirë trupit të Stalinit  
dhe karriget e zyrave i shndërron në frone...  
Frym nga Moska era e Kongresit të Njëzetë,  
Tetori kryqëzohet në ikset e tij si kryqe të mëdha  
dhe ngjiren së thirruri erërat e Kapitalit:  
Hosanà!... Hosanà!...

#### IV

Fluturojnë rrëth Kullës sime pëllumba që gugatin  
si pëllumbat e Zeusit në faltoren e Dodonës,  
pëllumba me pendë të bardha që t'i lëbyrin sytë...  
Fluturojnë pëllumbat nga perëndimi dhe lindja,  
fluturojnë nga Sheshi i Kuq, nga Sheshi i Shën  
Pjetrit,  
fluturojnë nga kambanat dhe amvonat e kishave  
dhe nga kupolat e pallateve të Gjenevës:

gu-gu, gu-gu gugatin pëllumbat  
rreth Kullës sime  
dhe unë dëgjoj: ku-ku, ku-ku!  
zërin e vërtetë të erës-pëllumb.

Thonë se erërat qenkan mbledhur diku në veri  
e paskan hapur koncilen e madh  
për paqtimin e botës,  
për të mbjellë paqe e siguri në lehët vullkanike  
të meridianeve e paraleleve,  
për të vendosur harmoninë e statukuonë  
mbi rrëmujën, rrebeshet dhe kundërtitë e shekullit.  
Dashkan erërat  
e pandehin se popujt nuk e dinë  
që pinjojtë e tyre janë  
gjakderdhjet  
e agresionet,  
e kriza... Dhe erërat  
u bien daulleve të tendosura të horizonteve  
me mësukën e raketave  
e me thuprën e ullirit  
shkarravitin qiejt me gjithfarë nënshkrimesh  
duke marrë pozën e gjykatësit të madh,  
të shpëtimtarit të madh  
e të kampionit të madh  
të paqes e të sigurisë  
së botës.

Betohen ererat në emër të çarmatimit,  
rrahin gjokset e tryezat me grushtet e tyre  
presidenciale, kryeministrore e diplomatike,  
shkelin pllajat, stepat e rrafshultat  
me tanket e tyre,  
predikojnë miqësinë e lirinë e ererave  
dhe ortakinë me ererat... E me buzëqeshje ererash  
propozojnë traktate e blloqe  
në emër të paqes e të lumturisë (postume)  
të botës.

Dam-dum, dam-dum, dam-dum!...  
Ererat u bien daulleve të zeza të vdekjes,  
u bien kambanave e marsheve funebre,  
sokëllijnë nëpër udhëkryqet e patalokët e viteve  
në emër të paqes  
e të sigurisë!

## V

Ato shpallin shtetrrethimin në trojet e tyre,  
vënë në lëvizje dunat, akullnajat e mjegullat polare,  
ndërsejnjë horizonteve tanket e hordhitë,  
priftërinjtë, spiunët, gjeneralët...  
Meridianet përgjaken nga agresionet e ererave  
dhe miliona njerëz mbeten pa liri,  
dhe miliona mbeten pa bukë e pa strehë,

dhe miliona mbeten pa ditur ç'të bëjnë me duart e  
tyre,  
dhe miliona të tjerë shurdhohen e trullosen  
nga krismat dhe shurukama e erérave.

Ulërin era që fryn prej tajgës e tundrës,  
sjell me vete ngricën e Siberisë dhe ciknën e polit,  
shqyen stinët dhe kufijtë e shteteve,  
gërvisht me thonj ballin e rrudhosur të popujve,  
gllabëron gradët e ngrohta të atmosferës së shekullit  
dhe përplaset si ortek në kufijtë e mi  
ta gjunjëzojë e ta shembë Kullën time.  
Kullën time të mbirë në shkëmb,  
Kullën time të kuqe  
e me kulmin te Dielli...

Dhe koha përgjaket  
nga urrejtja dhe mallkimi i popujve: He t'u zhbiftë  
fara!

Të xhumhistë rrufeja e t'i nxjerrtë korbi sytë,  
moj erë e pabesë e tradhtisë!  
Dam-dum, dam-dum, dam-dum...  
Përplasja e erës në fytyrat e zemëruara të popujve,  
përplasja e erës në fytyrat e bronzta të statujave  
dhe në konturet e tendosura të kufijve,  
përplasja e erës pas dyerve, fasadave, flamurëve,  
përplasja e erës pas viteve... Dhe përplasja

e grushteve të popujve  
mbi erën demagogjike, mbi erën  
renegate, mbi erën  
kanosëse.

## VI

Rreth Kullës sime shkrofëtin e hingëllin  
era e thatë që fryn nga shkretëtira e Gobit,  
kali i drunjtë i Trojës u shndërrua në kalin fluturues,  
mori formën e kalit mitologjik me tri kokë  
që ngjeth kohën me hingëllimën e tij,  
me trokun e tij të vërtikshëm e të papushuar,  
në sy ka etjen e pakufishme të shkretëtirës,  
valëvit nëpër qiej jelen e tij laragane  
të njëqind luleve e të njëqind shkollave  
përhap në partitë e zverdhura fryshtë e Lamës së  
Madh  
dhe rrëzon barrikada nëpër rrugët e botës...

Kali fluturues trikokësh kullot  
fëmijëritë njomëzake të ferishteve që lindin  
në patalokët e erërave,  
kullot liritë e shpresat e besimin e popujve,  
pi gjakun e kuq të proletarëve,  
shurdhon vitet me zhurmën e gongeve... Midis erërave

ngrihet zëri i Enverit më lart se gonget  
dhe cimbalet e Pekinit:  
Popuj dhe proletarë të botës,  
hingëllima ogurzezë e kalit fluturues me tri kokë  
është zëri i tradhtisë!

Trokon kali fluturues me tri kokë  
për krah kalit të zi të balozit të zi,  
kapërcejnë oqeane, varg male, kryeqytete, krahina  
për të gjymtuar me thundrat vigane  
stinët,  
për të kafshuar me nofullat e zeza horizontet  
dhe shtetet —  
duke nuhatur me flegrat e hapura  
duhmë gjaku, flakadanësh, rrënojash...

## VII

Përplasen pas mureve të strallta të Kullës sime  
erërat e Alaskës dhe erërat e Siberisë,  
era e thatë e mortore e shkretëtirës së Gobit —  
unë ndërtoj midis dimrit stinën time me diell,  
ndërtoj ëndrrën e shembur e të rishembur të botës,  
ngre lart Kullën time prej guri dhe drite,  
gdhend me duart e mia historinë.

Në tokën time lulet rriten  
dhe këto lule janë mugullim i djersës sime,  
janë mugullim i Diellit  
lulet e duarve të lira, të fjalës së çiltër,  
qytetet punëtore me petalet e lagjeve të reja,  
fshatrat e elektrifikuara që duken në mbrëmje  
si kopshte yjesh në shpatet e maleve,  
furrnaltat dhe uzinat ku çel mendimi i ri,  
hekurudhat, traktorët, fontanat e naftës,  
kallëzat ku bëhet buka e të gjitha ditëve,  
festalet, statujat, romanet,  
e qeshura e vogëlushëve dhe e qeshura e të mo-  
shuarve  
dhe vetë ditët që marrin formën e luleve,  
lule që sfidojnë erërat e acarta e të thata,  
lule të antiblokadës.

Jehon zëri im në zemrat e popujve,  
siç jehon zëri i popujve në Kullën time,  
zëri i tyre i vendosur, i ngrohtë, solidar.  
Zgjaten drejt meje duart e tyre vëllazërore.  
Kulla ime me kulmin te Dielli nuk është vetëm  
dhe s'ka asgjë në botë më të shurdhët,  
më të pathemeltë e më vetmitare se erërat...  
Kulla ime është mohimi i vëtmisë  
dhe Dielli i saj i përket rrugullimit.

## VIII

Në tokën time lulet rriten  
për t'ia shumëfishuar lulëzimin jetës sime  
dhe në horizontin e vështrimit të Enverit  
të gjitha rrugët e dinë se ku shkojnë,  
të gjithë hapat e të gjitha duart nuk kanë lodhje,  
të gjitha ditët agojnë të bukura.

Në Kullën time bie sahati i Diellit,  
shënon me tiktaket e tij vdekjen e erërave,  
shënon orët e mëdha të historisë, orët e revolucioneve  
mat kohën e popujve...

Kumbojnë mbi rruzull hapat e rëndë të popujve që  
ecin,  
dridhen qiejt nga grushtet e mëdha të proletarëve  
dhe vërshon kontinenteve flaka e kuqe e revolucionit  
si shpërthimi i purpurt i agimeve,  
shkrin topat, raketat dhe kambanat e erërave,  
shkrin skeptrin në duart e shahut,  
shkrin mikrofonin te buzët e presidentit,  
shkrin helmetat mbi kafkat e mercenarëve,  
shkrin tiarën mbi kokën e papës,  
shkrin monedhat në kasat e bankierëve,  
shkrin rezervat e arit dhe rezervat e plumbit,  
shkrin harqet e triumfit, monumentet e mbretërve,  
kryqet e thyera dhe kryqet e hekurta

të erërave..

Përsëri i kthen në metal të pastër  
për të derdhur shinat dhe statujat e nesërme.

Buçet revolucioni dhe djeg  
ikonat, çeqet, ultimatumet, traktatet... Djeg  
planet dhe hartat e luftërave  
mbi tryezat e gjeneralëve... Djeg  
biblat, doktrinat, poetikat,  
maskat, stemat, parukat  
kurorat me dafina  
dhe testamentet e vjetra,  
shndërrohet në nekropol plot grahma, tym e hi  
babilonia e erërave.

## IX

Kulla ime është bastion i Diellit,  
është bastioni i parë dhe i paepur i qëndresës  
kundër rrëmetit dhe ringjalljes së erërave,  
mposht rrëthimet dhe kryqézatat e erërave,  
zmbraps erërat që therin më shumë se bajonetat,  
shemb mullinjtë me erë të demagogjisë së tyre,  
zmadhon vitet, kapërcen shekujt,  
zgjeron rrezatimin e dritës së saj,  
Kulla ime e ngulur në zemër të globit,  
Kulla ime e kuqe

e me kulmin te Dielli...  
Në tokën time lulet rriten.  
Erërat sokëllijnë e buzëqeshin  
rreth Kullës sime,  
por derën time ua kam mbyllur erërave,  
mbyllur ua kam që në vitin '44,  
të mos ma vjedhin ajrin tim e bukën time,  
të mos m'i vjedhin lulet e kuqe të gjakut tim  
e zogjtë e bardhë të fjalëve të mia,  
të mos ma vjedhin emrin e të nesërmen,  
të mos ma vjedhin ngrohtësinë e dritën e Diellit  
e dashurinë për Diellin,  
ua kam mbyllur derën time erërave  
përjetësisht  
e do të rrezatojë pérjetësisht Kulla ime  
**DIELL.**

**1973-1980**

## PËRMBAJTJA

Rrathët e lisit .....	3
Me ty ngjitemi, Parti .....	5
Një epitaf për Besnikun .....	7
Shkrirësi dhe zogu .....	9
Korrik .....	10
Dashuria e nënës .....	11
Tregimi i gjyshes .....	13
Në shkollën e mbrëmjes .....	15
Një poeti të ri .....	16
Në rrugë .....	18
Murana e fundit e gjakmarrjes .....	20
Fëmija me balonë .....	22
Vlorës .....	24
Kur i buzëqeshnim njeri-tjetrit .....	26
Mullarët e vjeshtës .....	28
Trëndafili që më solle në spital .....	29
Fyelli i Panit .....	30
Hijet .....	32
Ndjesi .....	34
Vendlindja .....	36
I kuq është dielli që perëndon në mbrëmje .....	38
Të pish në burim .....	40

Antiburokratike .....	41
Grerézat .....	43
Në bregdet .....	45
Në 35-vjetorin e Brigadës XXV S .....	47
Matematika e trimërisë .....	49
Skicë për portretin e Ramë Sadrisë .....	50
Koha e kërkon njeriun me flatra .....	51
Kulla e braktisur .....	53
Vrasja e poetit .....	54
Në kështjellën e Krujës .....	56
Ruhuni nga e premtja e zezë, popuj! .....	58
«Humanizmi» i Amerikës .....	60
Kuajt e ekspeditës gjeologjike .....	62
Zanat e malit .....	64
Në pemëtore .....	65
Loja .....	66
Më erdhi në kantier letra jote .....	67
Flakët e dëborës .....	68
Mollëkuqja .....	69
Murimi real .....	71
Në fushim .....	72
Imazh i dhimbshëm fëmijërie .....	73
Njerëzore .....	75
Nëna dhe djali po ecnin nëpër shi .....	77
Persiatja e vreshtarit .....	78
Ai plumb ende vret .....	80
Ullinjtë e Ulqinit .....	81
Vallja me pushkë .....	82
Ndarja .....	83
Neroni i bjeshkëve .....	84
Në kohën e kryqeve .....	86
Guri murg .....	88
Mëngjes në pyll .....	90
Armikut të klasës .....	92

Borërat .....	94
Pushimet dimërore .....	96
Lulet e vatrës .....	97
Dy duar .....	99
Një fëmijë .....	104

## **POEMA**

E bardha vjeshtë .....	106
Zérat .....	117
Vallja e flakëve .....	122
Me kulmin te dielli .....	140